



5 Pa universitetë



9 Kur në dasma rrezikohet jeta



12 Grupet shqiptare kontrollojnë...



31 Ramazani - Muaji i mëshirës dhe...



35 Leximet eksplicite

Portreti i muajit..... 2

Editoriali 3

Dritë Slivova: Edhe 9 495 indekse 4

Drita Vitia: Pa universitete 5-6

D.S.: Shqipja nuk njih kufi 7

Lulzim Ahmeti: Aeroporti në menaxhim privat..... 8

Fatos Shala: Kur në dasma rrezikohet jeta..... 9

Astrit Veliqi: Arkëtimi nga mërgimtarët..... 10

Dritë Slivova: Shtohen rastet e dhunës..... 11

Gëzim Qerimi: Grupet shqiptare kontrollojnë tregjet e heroinës në Evropë 12-13

Blerta Breznica: Veshjet shqiptare – tradita në haririm 14-15

Hekuran Avdyli: Mungojnë xhamitë – xhemati në rrugë 16

Bujar Isma: Rahoveci me xhami të re 17

Milazim Mustafa: Çështja e moralit dhe e normave morale në shoqërinë tonë 18-19

Intervistë me kryetarin e Gostivarit, Rufi Osmanin.. 22-24

Baki Rexhepi: Mes integritit dhe ndarjes nga Serbia..... 25-27

Muhamed J. Kajolli: Lufta për prefekturat ... 28-30

Ajni Sinani: Ramazani – Muaji i mëshirës dhe i bujarisë 31-32

Agim Avdiu: Bota është mbërthyer në fatkeqësi . 33-34

Flamur Maloku: Leximet eksplicite 35-36

Hatixhe Beqiri: Poezi 36

Intervistë me aktorin Mentor Zymberaj 37-38

Alban Bilalli: Pas GJND-së përballje edhe në sport 39

Intervistë me futbollistin kosovar, Andis Shala..... 40



REVISTË PËR AKTUALITET, KULTURË, ARSIM, ETIKË
Viti V / Nr. 45
19 gusht 2010 - 19 shtator 2010

Botues

Zëri Ynë

O.J.Q. "Zëri Ynë"

Drejtor

Muhamed Jusufi - KAJOLLI
kajolli5@hotmail.com

Redaktor përgjegjës

Avni AVDIU

avni.avdiu@gmail.com

Redaktor i kulturës

Flamur MALOKU

flamurmalko@hotmail.com

Redaktor teknik/Grafika

Osman D. GASHI

osmangashi@msn.com

Redaktore gjuhësore

Mimoza SINANI

e-mail:

revistapaqja@gmail.com

revistapaqja@hotmail.com

http://www.zeri-yne.org

Adresa:

Rr. Xhavit Mitrovica, nr. 14,
përballë teatrit Dodona,
Prishtinë, Kosovë

Njoftojmë bashkëpunëtorët se do të merren në konsiderim për botim vetëm ato shkrime që arrijnë në redaksi deri me datën 8 të muajit!



Premton njohje të reja

Pas opinionit të GJND-së për Kosovën dhe performimit të suksesshëm në OKB, është ngritur opinioni pozitiv për Ministrin e jashtëm të Republikës së Kosovës Skender Hyseni. Ai kërkoi zëvendësimin e Rezolutës 1244 me një të re që do të merrte parasysh realitetin në Kosovë, si dhe shprehu synimin e Qeverisë së Kosovës për anëtarësim në Kombet e Bashkuara. Nga ana tjetër, Veton Surroi, kryetar i bordit të Klubit për Politikë të Jashtëme e ka quajtur gabim strategjik kërkesën e Ministrit të Jashtëm Skender Hyseni për një rezolutë të re për Kosovën. Sipas tij, kërkesa e tillë do të ketë pasoja në riangazhimin e shteteve të cilat janë kundër pavarësisë së Kosovës që çështjen e Kosovës ta ritrajtojnë brenda Këshillit të Sigurimit. Kryeministri Thaçi ka reaguar, duke deklaruar se kërkesa e Ministrit të Jashtëm të Kosovës është politikë e Qeverisë së Kosovës. Ai e lavdëroi prezantimin e ministrit Hyseni në seancën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Në një intervistë për gazetën austriake "Der Standard", ai ka thënë se priten mbi 35 njohje të reja, duke përfshirë pesë vende të BE-së. Ministri Hyseni theksoi se Kosova është e përgatitur t'i përgjigjet çdo sfide që mund të dalë pas verdiktit të GJND-së.

Po ashtu, ministri Hyseni ka vizituar në qendrën e paraburgimit në Sheveningen – Hagë kryetarin e AAK-së, Ramush Haradinajn. Ai i ofroi atij solidaritetin dhe mbështetjen e plotë, duke shfaqur bindjen se Haradinaj do ta dëshmojë sërish pafajësinë e tij plotë. ■



BIOGRAFIA:

Skender Hyseni lindi më 17 shkurt 1955, në komunën e Podujevës. Filloren dhe të mesmen i kreu në vendlindje, ndërsa studimet në degën e gjuhës dhe letërsisë angleze në Prishtinë. Studioi edhe në Bloomsburg State College, SHBA (1978) dhe në Universitetin e Aberdinit, Skoci (1986). Veprimtarinë politike e filloi që nga themelimi i Lidhjes Demokratike të Kosovës, më 1989. Më 1992 u angazhua në Qendrën për Informim të Kosovës (QIK) si gazetar dhe përkthyes. Ishte redaktor dhe bashkëthemelues i Kosova Daily Report (buletin lajmesh në gjuhën angleze). Ka qenë këshilltar i presidentit Rugova dhe pjesëmarrës në konferencën e Rambujesë. Pas vdekjes së Rugovës vazhdoi punën si këshilltar i presidentit Fatmir Sejdiu. Ishte anëtar i të gjitha delegacioneve të Kosovës në bisedimet për status dhe zëdhënës i Ekspertit Negociator të Kosovës. Në zgjedhjet e fundit parlamentare është zgjedhur deputet, kurse në seancën e parë të kuvendit është zgjedhur Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Është anëtar i kryesisë qendrore të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe kryeson komisionin për marrëdhënie me jashtë të kësaj force politike. Po ashtu, është anëtar i komisionit kushtetues të Kosovës. Më 3 prill 2008, z. Hyseni është zgjedhur Ministër i Punëve të Jashtëme i Republikës së Kosovës. Është i martuar me znj. Drita Hyseni. Ka katër fëmijë: dy vajza dhe dy djem.

BUKA

Te shqiptarët ende vazhdon entuziazmi i fitores së Kosovës në GJND. Zaten kjo është edhe shumë e arsyeshme. Pa mëdyshje ky rezultat (10:4), do të sjell vetëm zhvillime edhe më pozitive në të ardhmen. Ka gjasa që pas kësaj edhe Serbia të kthjellet, ndonëse ka pak shenja në këtë drejtim.

Kosova është në rrugë të mbarë, prandaj lipset investuar edhe më shumë në diplomaci, ashtu që të mos shërbejë e arritura si satisfaksion, por për më tepër si motiv. Kësajsoj e udhës do të ishte që në këtë drejtim të mobilizohen të gjitha forcat për avancimin e proceseve përpara: kush ku mundet më shumë të kontribuojë, ashtu që të arrihet caku përfundimtar (anëtarësimi i Kosovës në OKB, etj.).

Mirëpo ajo çfarë i duhet për momentin stabilizimit politik në Kosovë krahas forcimit të përpjekjeve diplomatike në lobim dhe afirmim të Kosovës, është edhe joshja e investitorëve për investime sa më të mëdha në vendin tonë. E dalë nga një shkatërrim sistematik njëzetvjeçar, nga një shfrytëzim i pamëshirshëm qindvjeçar dhe nga një luftë që ka atakuar drejtpërsëdrejti edhe ekonomitë familjare, Kosova më shumë se çdo vend tjetër i rajonit ka nevojë për një këndellje ekonomike. Çfarëdo krize eventuale në rrafshin global ose rajonal (e të mos flasim për ndonjë katastrofë të mundshme natyrore, larg qoftë), do të ishte me pasoja më të thella për Kosovën, andaj kjo nuk duhet të na gjejë gafil.

Rast eklatant është së fundi rritja e çmimit të bukës. Sado që 5 centëshi për dikë mund të mos paraqes ndonjë problem serioz, për dikë tjetër mund të pakësojë edhe ashtu standardin e mjerë jetësor; aq më tepër kur kihet parasysh fakti se afro 20% është në zgrip të ekzistencës ose siç thuhet ndryshe në varfëri ekstreme. Jo rrallëherë

shohim rrugëve njerëz që kafshatën e gojës e kërkojnë edhe nëpër kontejnerë të bërrlokut, andaj problemi si problem nuk duhet nënvlerësuar.

Duhet hartuar politika efikase ekonomike që do të rrisnin dukshëm investimet në sektorin bujqësor, duke subvencionuar fermerët, ashtu që të ketë rendimente më të mëdha të grurit. Kosova ka kapacitete që ta ushqejë popullatën e vet, por pak i është dhënë rëndësi prodhimit të grurit, krahasuar me 110 mijë hektarë që mbilleshin më parë, kjo sipërfaqe tashmë është zvogëluar ndjeshëm.

Për rrjedhim duhet menduar që në raste të tilla, shtresa më e varfër të ndihmohet, ashtu që të mos përballet me mungesën e kafshatës së gojës.

Përndryshe kriza e ngritjes së çmimit të bukës e shkaktuar nga temperaturat e larta (thatësia) dhe nga zjarret në Rusi ka përfshirë edhe popullsinë e Lindjes së Mesme, Amerikës, Afrikës dhe Evropës. Analistët parashikojnë se nëse çmimi do të vazhdojë të rritet, atëherë do të jetë i pashmangshëm ndalimi i protestave të mëdha. Shumëçka do të varet se sa do të zgjasë kjo krizë dhe ndikimi që do të ketë ky çmim edhe në pjesët e tjetra të botës.

Në këtë muaj të Ramazanit, kur një pjesë e popullatës myslimane edhe agjëron, përballa me mungesën e bukës, do të ishte diçka e pafalshme. Prandaj krahas solidaritetit të shtresës më të pasur me atë më të varfër, duhet angazhuar edhe qeveria me masa përkatëse që kjo krizë të mos prek seriozisht skamnorët e shumtë. ■



Universiteti i Prishtinës e ka rritur numrin e studentëve të rinj



Edhe 9 495 indekse

Për vitin e ri akademik 2010-2011, në Universitetin e Prishtinës (UP) janë pranuar 9 104 studentë në studime të rregullta, ndërsa 355 me korrespondencë. Zyrtares për informim të UP-së, Isuf Ibërdemaj, ka njoftuar për revistën “Paqja” se për afatin e ardhshëm të regjistrimeve kanë mbetur edhe 7 078 vende të lira për studime të rregullta, ndërsa për ato me korrespondencë edhe 675 vende.

Dritë SLIVOVA

Dita e shpalljes së rezultateve të provimit pranues në Universitetin e Prishtinës (UP) ka qenë për dikë ditë gëzimi, por për disa të tjerë është shoqëruar edhe me lot hidhërimi. Egzon Ibishi, i cili tashmë është pranuar në drejtimin e marketingut, si dukej preferonte ta ndante gëzimin e tij me të gjithë. Ai është shprehur, për revistën “Paqja”, se më së shumti është gëzuar që nuk i ka shkuar edhe një vit pa u regjistruar, sepse vitin e kaluar akademik ai nuk kishte pasur mundësi t’u bashkohej shokëve të vet moshatarë. “Vitin e kaluar nuk jam pranuar për tri pikë dhe kam qenë mjaft i mërzhitur. Ndërsa këtë vit e ndieja se do të kaloja për arsye se isha

shumë i sigurt në pyetjet e provimit”, - është shprehur ky student. Ndërsa Anila Shala e cila nuk është pranuar në këtë afat, ka thënë se vazhdon t’i mbajë shpresat për afatin e ardhshëm. “Kësaj radhe nuk jam pranuar, por, sidoqoftë, në shtator do të jem më e përgatitur dhe do të mundohem maksimalisht të jem pjesë e Fakultetit Juridik, siç kam pasur gjithmonë dëshirë”, - ka thënë Anila.

Kanë mbetur edhe shumë vende të lira

Në shtatëmbëdhjetë njësitë akademike të Universitetit të Prishtinës (UP), do të studiojnë edhe 9 495 studentë në vitin e ri akademik 2010-2011. Sipas zyrtares për informim në UP, Isuf Ibërdemaj, procesi i provimit ka shkuar

me rregull e po ashtu edhe procesi i kontrollimit të provimeve. “Fatmirësisht nuk kemi pasur asnjë parregullsi. Provimi ka filluar në kohën e duhur për të gjitha fakultetet, ndërsa komisionet e përbëra nga UP-ja, të cilat kanë qenë të angazhuara për kontrollimin e provimeve, kanë sjellë raportin e tyre ku vërehet se i tërë procesi ka shkuar për së mbari”, - ka shpjeguar Ibërdemaj. Ai ka bërë të ditur se afati i dytë për regjistrim do të shpallet nga mesi i muajit shtator. Është paraparë që me konkurs të regjistrohen 16 182 studentë të rregullt, ndërsa me korrespondencë 1 030 studentë. Sipas Ibërdemajt, nga këto shifra, duke e krahasuar me numrin e të pranuarve, vërehet se kanë mbetur edhe shumë vende të lira për regjistrim. ■

Akreditimi i dytë me radhë i institucioneve private

PA UNIVERSITETE

Drita VITIA

Tetëmbëdhjetë institucione private të arsimit të lartë në Kosovë, të cilat kohë më parë janë akredituar nga Agjencia Kosovare e Akreditimit (AKA), kanë shpallur konkurs për pranimin e studentëve të rinj për vitin e ri akademik 2010/11. Institucionet e kanë bërë një gjë të tillë menjëherë pasi u është dhënë drita e gjelbër nga AKA-ja për zhvillimin e punës. Bartësit Privatë të Arsimit të Lartë (BPAL), me reklamat e tyre në forma të shumta, si billborde, broshura, fletushka të ndryshme, pllakate etj., kanë vërshuar të gjitha qytetet e Kosovës, madje edhe hapësirat e Universitetit Publik të Prishtinës, vetëm e vetëm që të regjistrojnë një numër të mjaftueshëm të studentëve në vitin e parë të studimeve.

Asnjë universitet

Megjithatë, Agjencia Kosovare e Akreditimit (AKA), as për të dytën herë me radhë të akreditimit, nuk ka arritur ta akreditojë asnjë Bartës Privat të Arsimit të Lartë (BPAL) në Kosovë me titull universitet. Udhëheqësit e AKA-së, e kanë arsyetuar një gjë të tillë me mungesën e personelit akademik dhe me mungesën e zhvillimit të punës hulumtuese-shkencore në këto institucione. Megjithatë, kryetarja e Këshillit Kombëtar të Cilësisë (KKC), Ferdije Zhushi Etemi, ka thënë se kushtet dhe standardi i këtyre institucioneve është



përmirësuar dukshëm në krahasim me një vit më parë. Ajo ka shtuar se BPAL-të kanë arritur ta kenë një nivel shumë më të lartë të cilësisë në studime, të kenë hapësira më të mëdha për çka edhe nuk u kufizohet numri i studentëve që do të pranojnë, siç ka qenë vitin e kaluar. AKA këtë vit, po ashtu, ka akredituar programe dhe institucione për më tepër se një vit, çka nuk ka qenë vitin e kaluar, kur të gjithë BPAL-të ishin akredituar për vetëm një vit kohëzgjatje. “KKC vlerëson se ka pasur lëvizje pozitive në ngritjen e cilësisë së studimeve në BPAL gjatë vitit akademik 2009/10 dhe çmon përpjekjen e institucioneve për t’i përbushur rekomandimet e dhëna n g a ekipet e





ekspertëve të akreditimit një vit më parë, - thuhet në raportin e akreditimit. Ndërkohë, AKA, në bazë të ligjit për arsimin e lartë (2002/3), në vitin akademik 2009/10, ka zhvilluar procesin e ri të akreditimit të BPAL-ve në Kosovë. Procedurat e akreditimit janë realizuar konform standardeve dhe udhëzimeve evropiane për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë, Udhëzimin Administrativ për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë (2009/1), Udhëzimin Administrativ për akreditimin e shkollave të larta profesionale teknike 2009/6, si dhe të dokumenteve të publikuara të AKA-së. Në këtë proces në ekipet vlerësuese kanë marrë pjesë ekspertë ndërkombëtarë nga vendet e ndryshme të Evropës si Austri, Gjermani, Angli, Irlandë, Finlandë, Danimarkë, Zvicër, Slloveni, etj. Procesi për akreditimin e këtyre institucioneve ka filluar më 1 tetor 2009 dhe ka përfunduar më datën 7 korrik 2010, me mbledhjen e KKC të AKA-së në të cilën janë marrë vendimet për akreditim.

BPAL të akredituara nga AKA

Këshilli Kombëtar i Cilësisë i ka rekomanduar Qeverisë së Kosovës që të akreditohen këto institucione private të arsimit të lartë në Kosovë, duke cekur se asnjë BPAL aktualisht nuk i përmbush kriteret për të bartur emrin universitet, për të dhënë tituj akademik për mësimdhënësit, si dhe për të ofruar studime të doktoratës. ■

Akreditimi dhe joakreditimi

Riakreditohen:

-BPAL Kolegji AAB-Riinvest
-BPAL Kolegji FAMA

-BPAL Kolegji ILIRIA

-BPAL Kolegji UBT

-BPAL Kolegji DARDANIA

-BPAL Kolegji VICTORY

-BPAL Kolegji për Studime të Menaxhmentit Ndërkombëtar (KSMN)

-BPAL UNIVERSUM

-BPAL BIZNESI

-BPAL Instituti për Studime të Shkencave të Aplikuara Organizative "Pjetër Budi"

-BPAL "Gjilani"

-BPAL Shkolla e Lartë Profesionale e Artit "Evolucion"

-BPAL Shkolla e Lartë Profesionale "TEMPULLI"

-BPAL Shkolla e Lartë teknike "Design Factory"

Bartësit Privatë që akreditohen për herë të parë janë:

-BPAL "Shkolla Evropiane për Drejtësi dhe Qeverisje"

-BPAL "Instituti për Studime Politike dhe Evropiane"

-BPAL Shkolla e lartë Profesionale "BIOMEDIKA" (akreditim me kusht)

-BPAL Shkollë e lartë Profesionale "QEAP-HEIMERER" (akreditim me kusht)

Institucionet private të arsimit të lartë që nuk akreditohen

1. BPAL 'UNIPZ'

2. BPAL Instituti 'ADesign'.



Nxënësit jashtë Kosovës kanë mundësi të mësojnë edhe në gjuhën amtare

SHQIPJA NUK NJEH KUFI



Nxënësit shqiptarë, të cilët jetojnë jashtë Kosovës, e zhvillojnë mësimin në gjuhën shqipe sipas programit të ri për mësim plotësues në diasporë. Sipas njërit prej hartuesve të këtij programi mësimor, Nuhi Gashi, ky dokument është duke iu shërbyer nxënësve shqiptarë jashtë Kosovës që të jenë më afër historisë së popullit tonë, por edhe më pranë gjuhës shqipe.

Amir Haliti, nxënës i klasës së tetë në një shkollë fillore të qytetit Shtafel të Gjermanisë, ka njoftuar se tashmë orëve mësimore në gjuhën shqipe u ka ndryshuar përmbajtja. Ky nxënës ka shpjeguar për revistën “Paqja” se lëndët kryesore të cilët i mësojnë janë gjeografia dhe historia. “Gjatë orëve në gjuhën shqipe mësojmë për territorin e Kosovës dhe për historinë e bujshme të popullit tonë”, - ka njoftuar ky nxënës. Sipas tij, ata mbajnë dy orë në javë mësim në gjuhën shqipe, kryesisht në orët e pasdites, ndërsa në vit i bie që të zhvillojnë rreth 73 orë mësim në gjuhën shqipe.

Identiteti kombëtar

Sipas njërit prej hartuesve të programit për mësim plotësues në diasporë, Nuhi Gashi, qëllimi kryesor i programit mësimor është zhvillimi dhe ruajtja e

identitetit kombëtar përmes mëimit të gjuhës, kulturës së origjinës, si dhe njohjes me trashëgiminë dhe thesarin kulturor, natyror dhe historik kombëtar. Ai, po ashtu, ka shpjeguar se ky dokument i referohet tri qëllimeve kryesore, që sipas tij janë, shkolla dhe identiteti kombëtar, shkolla dhe integrimi dhe shkolla dhe kthimi në atdhe. “Identiteti kombëtar dhe kulturor i shqiptarëve në diasporë ndihet dhe pranohet unik në mënyrë ngulmuese, të natyrshme e me krenari dhe asisoj është projektuar edhe në këtë program mësimor. Megjithatë, kjo, përveçse identifikon dhe përcakton minimumin e domosdoshëm të kompetencave në kuadër të synimit të ruajtjes dhe zhvillimit të këtij identiteti, merr parasysh dallimet ekzistuese juridike e administrative të shtrirjes hapësinore shumështrëshe të shqiptarëve”, - ka njoftuar Gashi.

Objektivat e dokumentit mësimor

Ndërsa sa i përket objektivave kryesore të programit mësimor, Nuhi Gashi ka shtuar se ato synojnë që t’i aftësojnë nxënësit shqiptarë të diasporës për komunikimin në gjuhën shqipe në kontekste të ndryshme, përmes bisedës, shkrimit, leximit, duke përfshirë edhe komunikimin artistik. “Njëkohësisht, përmes këtij programi mësimor, jemi munduar që nxënësit shqiptarë të njohin, të kuptojnë dhe të çmojnë traditën, vlerat dhe të arriturat kombëtare në letërsi, në arte dhe në veprimtari të tjera materiale dhe shpirtërore, e më konkretisht të njohin dhe të analizojnë në mënyrë kritike zhvillimet më të rëndësishme të historisë së kombit shqiptar, si pjesë e historisë së përgjithshme të njerëzimit”, - ka shtuar për fund Gashi.

Përgatiti: D.S.



AEROPORTI NË MENAXHIM PRIVAT

Lulzim AHMETI

Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës (ANP) do ta menaxhojë për 20 vjet konzorciumi franko-turk “Limak & Lyon”, i cili është i obliguar t’i modernizojë shërbimet e ANP-së, që do t’i ofrojë për udhëtarët. Ai është i detyruar me kontratë që të ofrojë të hyra për buxhetin e Kosovës. Zyrtarë qeveritarë patën thënë se kjo është mënyra më e mirë dhe më e duhur për të modernizuar shërbimet e aeroportit, edhe pse aeroporti ka qenë kontribuues goxha i madh për buxhetin e Kosovës.

Procesi i zgjedhjes së koncesionarit u karakterizua me kritika, pasi që kishte të pakënaqur nga ky proces i futjes së sektorit privat në atë publik.

“Limak & Lyon” do të ndërtojë një terminal modern, do të përmirësojë ofrimin e shërbimeve, si dhe do të investojë 100 milionë euro në aeroportin e vetëm për fluturime civile në Republikën e Kosovës. Edhe pse nën menaxhim publik, Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës, për nga ofrimi dhe cilësia e shërbimeve kishte qenë shumë më përpara se disa aeroporte të vendeve të rajonit. Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës, njëmbëdhjetë vite pas luftës ka ndryshuar shumë në ofrimin e shërbimeve, por ai duhet të ndryshojë edhe më shumë për të qenë në hap me aeroportet e vendeve evropiane. Gjatë menaxhimit publik, si pronë e Qeverisë së Kosovës, ANP-ja kishte pasur mbi 50 milionë euro investime kapitale në projekte të ndryshme. Ndër projektet, në të cilat u investua, janë: projekti për

rregullimin e pistës si dhe përshtatja e saj për fluturime edhe gjatë natës, rregullimi i kullës së trafikut ajror, ndërtimi i qendrës VIP, si dhe projekte të tjera të duhura dhe të rëndësishme për një aeroport modern. Po ashtu ANP-ja e ka rritur çdo herë numrin e udhëtarëve dhe numrin e të hyrave për buxhetin. Aeroporti, nga një kompani që “hante” buxhetin e vendit, ishte kthyer në një komani që kontribuonte për buxhetin.

Këto dhe të dhëna të tjera statistikore të bëjnë të mendosh se ndoshta u bë gabim që Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës u dha me koncesion!

Ekspertë të ekonomisë, ndonëse e kanë kritikuar mënyrën e dhënies me koncesion të aeroportit, kanë thënë se procesi i koncesionimit të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës është proces i pandalshëm për transferimin e menaxhimit të tij nën menaxhim privat. Procesit të koncesionimit të aeroportit i është dhënë mbështetje e fuqishme ndërkombëtare, duke përfshirë edhe mbështetjen e Ambasadorit Amerikan në Prishtinë, Christofer Dell.

Çfarë do të ndodhë me punëtorët?

Por nga krejt ky proces, si në të gjitha proceset e koncesionimit dhe bartjes së menaxhimit nga sektori publik në atë privat, më së shumti e pëson klasa punëtorë, edhe pse zyrtarisht askush nuk ka thënë se sa humbje të vendeve të punës do të ketë në ANP. Kjo kuptohet nga vetë fakti se, që nga viti 2004 kur filloi privatizimi në Kosovë, çdo ndërmarrje e cila është marrë në menaxhim nga sektori privat e ka shkurtuar numrin e punë-

torëve. Deri më tash, sipas statistikave, i kanë humbur vendet e punës 75 mijë njerëz. Nga ky proces nuk do të kalojnë bash mirë edhe punëtorët e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës, edhe pse ata kanë marrë garancione se vendet e tyre nuk do të preken, së paku për tre vite e jo për pesë siç kishte kërkuar Sindikata e Punëtorëve të Aeroportit.

Ende nuk dihet se a do të paguhet me pagat aktuale punëtorët e aeroportit, të cilët kanë qenë ndër më të paguarit në Kosovë, së bashku me punëtorët e PTK-së. Edhe për menaxhuesit e ANP-së është thënë e nuk do të hiqen nga pozitat e tyre, por pas koncesionimit edhe ata mund të shkojnë, ose ndoshta nuk do ta kenë “fatin” e vartësve të tyre që së paku për tre vite ta kenë të sigurt vendin e punës.

Për 20 vite, 100 milionë euro investime

Konzorciumi “Limak & Lyon”, i cili ka fituar tenderin për koncesionimin e ANP-së, do të investojë rreth 100 milionë euro, duke ndërtuar një terminal të ri, në të cilin do të ofrohen shërbime më të mira për pasagjerët që do të udhëtojnë, një parking të ri për automjete, si edhe do të bëjë shtrimin e pistës. Po ashtu, ky konzorcium do t’i japë nga të hyrat e aeroportit një mesatare prej 39.42 për qind buxhetit të Kosovës për 20 vite sa do të menaxhojë Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës.

Por zyrtarë të qeverisë kanë thënë se, për këto 20 vjet, investimet direkte dhe indirekte në buxhetin e Kosovës mund të jenë deri në 450 milionë euro. ■

Ahengjet familjare në Kosovë, në disa raste, po përfundojnë tragjikisht

Kur në dasma rrezikohet jeta

Fatos SHALA

Përdorimi i armëve të zjarrit në ahengjet familjare në Kosovë, në disa raste, po përfundon tragjikisht. Një fat të tillë, në fund të kësaj jave, ka përjetuar dyvjeçari nga Mitrovica, i cili është plagosur nga të shtëna armësh në një aheng në të njëjtin qytet. Arbër Beka, zyrtar në Policinë e Kosovës, thotë se tashmë policia ka marrë aksion për ndalimin e të shtënave dhe arrestimin e personave të cilët mbajnë ilegalisht armë zjarri. E, në anën tjetër Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP), ka organizuar disa herë fushata kundër shkrepjeve me armë zjarri në ahengje familjare, duke e quajtur kampanjën “Festo me zemër, jo me armë!”

“Festo me zemër, jo me armë!”

Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) ka organizuar disa herë fushata kundër shkrepjeve me armë zjarri në ahengje familjare, duke e quajtur kampanjën “Festo me zemër, jo me armë!” Hana Obërtinca, zyrtare në UNDP, thotë se si rezultat i vetëdijesimit të qytetarëve përmes fl-

etushkave, ka rënie të aksidenteve nga të shtënat me armë në ahengje.

“Projekti i UNDP-së për kontrollin e armëve ka organizuar fushatën mediale “Festo me zemër, jo me armë!”. Kemi shpërndarë fletushka, që u janë dedikuar të gjitha veturave nga policia kufitare dhe nga statistikat që janë marrë nga Policia e Kosovës ka pasur rreth 40 për qind rënie të aksidenteve nga të shtënat me armë në dasma”, - shpjegon Obërtinca. Ndërkaq, Mehmet Halimi, qytetar nga Prishtina, tha se të shtënat në dasma praktikohen nga dasmorët, por janë të rrezikshme. “Edhe këtu në Prishtinë po gjuajnë me armë. Tash është bërë shprehje madje të gjuajnë me armë nëpër dasma edhe fëmijët, por mendoj që nuk është e drejtë e fëmijëve të shkrepin armët, sepse është shumë e rrezikshme”, - shprehet ai. Sidoqoftë, sipas zyrtarëve policorë, do të vazhdojnë angazhimet shtesë për konfiskimin e armëve p a leje, si dhe për ruajtjen e jetës së qytetarëve.

Arbër Beka, zyrtar në Policinë e Kosovës, u shpreh se tashmë policia ka marrë aksion për ndalimin e të shtënave dhe arrestimin e personave, të cilët mbajnë ilegalisht armë zjarri. Ai, po ashtu, tha se shumica e fundjavave, në një mënyrë, po janë të përgjakura. “Gjatë vikendit në Mitrovicë është plagosur një fëmijë dyvjeçar nga një plumb qorr, derisa ishte duke ecur me prindërit e tij. E shtëna ka ardhur nga një aheng familjar”, - bën të ditur Beka. Por, rastet e plagosjeve nuk janë të rralla. Ditët e fundit edhe një fëmijë trembëdhjetëvjeçar, si dhe një femër, janë plagosur derisa ishin duke pritur në stacionin e autobusëve. “Si pasojë e përdorimit të armëve në ahengje, ditët e fundit nga shkrepja në aheng është plagosur edhe një fëmijë trembëdhjetëvjeçar”, - shtoi Beka

“Po ashtu, është goditur edhe një femër nga gëzhoja e plumbit, me çrast ajo është lënduar rëndë. Duke u nisur nga këto aksidente, policia ka marrë angazhime shtesë nëpër dasma dhe do të trajtojë çdo informatë për përdorimin e armës së zjarrit në ahengje”. ■

**Fund-
javat e përg-
jakura**




ARKËTIMI NGA MËRGIMTARËT

Astrit VELIQI

Vapa përcëllon kudo. Disa kalonjë kohën buzë plazheve e bregdeteve. Disa janë të preokupuar me gazmende familjare. Hijeshinë gazmendeve ua japin edhe mërgimtarët.

Dasmat dhe ahengjet e ndryshme familjare në këtë kohë janë shumë aktuale. Herë-herë del në pah edhe tradita e hershme, e cila na kujton kohën kur jehonte daullja e çiftelia.

Shpenzimet e shumta ,që bëhen nëpër këto gazmende, pranohen edhe nga disa të rinj mërgimtarë. Astrit Pirraku, i cili jeton aktualisht në Itali, është i kënaqur me atmosferën që po krijojnë dasmat dhe familjet kosovare.



Astrit Pirraku

Ai mendon se tradita duhet ruajtur, ngase në këtë mënyrë ruhen edhe ritet dhe identitetet e martesave në Kosovë.

"Pajtohem me mënyrën e organizimit të dasmave tradicionale, por jo me teprimet, ngase po bëhen shpenzime tej mase për një dasmë. Si të tilla bëhen të rënda për buxhetin edhe ashtu të brishtë të familjeve kosovare", - shton ai.

Edhe këtë vit, sikur viteve të tjera, dorën në zemër, nuk është bërë mjaftë për mërgatën. Ajo që vlen të ceket është se për nder të tyre tashmë janë bërë tradicionale "Ditët e Mërgatës në Kosovë".

Kanë qenë plot tri ditë, kohë kjo që i është dedikuar mërgatës në Kosovë, ku me aktivitete të ndryshme kulturore-artistike i është uruar mirëseardhja mërgimtarëve tanë në vendlindjen e tyre të dashur, në Kosovën Republikë.

Tri ditë për Mërgatën në Kosovë

Naim Dedushaj, drejtor i Zyrës për Çështje jo rezidente pranë kryeministrit, ka thënë se ky aktivitet tradicional, i cili po mbahet për të katërtën herë me radhë, më parë është organizuar në disa komuna të tjera të Kosovës, kurse tani po mbahet vetëm në Komunën e Prishtinës.

Ai më tutje ka shtuar se çdo gjë po shkon sipas planifikimit dhe interesimi i mërgimtarëve për pjesëmarrje në këtë aktivitet është i lartë.

Koncertin "Ditët e Mërgatës në

Kosovë" zyrtarisht e hapi doajenia e këngës së mirëfilltë shqiptare, Nexhmije Pagarusha, e cila u shpreh e lumtur, por edhe e emocionuar, për faktin se takohet me mërgimtarët këtu në Kosovë.

"Jam shumë e lumtur që i përshëndeta mërgimtarët tanë, të cilët kanë dhënë kontribute të jashtëzakonshëm për ekzistencën tonë dhe për këtë i falënderoj nga zemra për të gjitha këto gjëra që keni bërë ndër vite për ne", - u shpreh Pagarusha.

Majlinda Gashi, e cila jeton në Gjenevë, u shpreh mjaft e kënaqur për këto aktivitete kulturore.

Ajo tha se kultura është ambasadori më i mirë i secilit vend dhe mundësi e mirë për t'u inkuadruar në shoqërinë ku jetojmë.

"Në aktivitete të tilla ne prezantojmë veshjet, kulturat dhe traditat tona shekullore shqiptare, dhe si të tillë ne jemi si ambasadorë të kulturës në vendin ku jetojmë", -shtoi ajo.

Diaspora mbështet ekonominë e Kosovës

Diaspora mbetet edhe më tej një promotor i fuqishëm i ekonomisë kosovare, gjë të cilën e pranon edhe Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, ndonëse shënohet rënie e dukshme, sepse përderisa në vitin 2003 dërgesat e mërgimtarëve tanë arrinin në rreth 600 milionë euro, në vitin e kaluar ato patën rënë në rreth 350 milionë euro. ■

Një raport tremujor tregon për raste të shpeshta të dhunës në familje

SHTOHEN RASTET E DHUNËS

Në raportin e Policisë së Kosovës, për tre muajt e parë të vitit 2010, statistikat kanë treguar se ende janë të shpeshta raportimet për rastet e dhunës në familje. Nga qendrat kryesore të Kosovës, sipas raportit policor, del se janë kryesisht femrat ato që raportojnë për rastet e dhunës të ushtruara ndaj tyre.

Dritë SLIVOVA

Sipas raportit të Policisë së Kosovës, rastet e raportuara të dhunës në familje, kryesisht në tre muajt e parë të vitit 2010, arrijnë shifra të larta. Nga ky raport del se pjesa kryesore që raporton për keqtrajtim psikik janë gratë. Për tre muajt e parë janë raportuar gjithsej 194 raste të dhunës në familje, prej tyre 155 femra ndërsa dyzet e katër meshkuj.

Faktorët e dhunës

Sipas sociologut Fadil Maloku shtimi i dhunës mbi subkulturën femërore në rastin e Kosovës i duhet adresuar kryesisht disa faktorëve, ndër të cilët, sipas tij, dominues janë ata të natyrës ose rrjetit social, si edhe ata të shprishjes së raporteve në përgjithësi. "Kur flasim për faktorin e parë, mendojmë gjithsesi në rrjetëzimin social, pra procesin e formësimit të subkulturës femërore në kushtet dhe rrethanat e një ambienti të ri, ku partnerët kryesorë të një familje kanë rritur ambiciet, referencat, si edhe

kërkesat që nganjëherë dinë të bëhen objekt i konflikteve dhe në fund edhe ushtrimit të dhunës. Në këto raste, padyshim, që viktimat më të shpeshta janë femrat. Në anën tjetër, meshkujt janë një indikator gjithnjë potencial që e artikulojnë më fuqishëm këtë pakënaqësi si me statusin social, ashtu edhe atë ekonomik", - ka shpjeguar sociologu Fadil Maloku. Sipas tij, trajtimet e tilla të dhunës në ambientet ku ajo ushrohet, reflektohet edhe te gjendja ose statusi emocional që zakonisht përcillet me strese, ngarkesa dhe pakënaqësi, që mund të rriten si pasojë e frustrimit permanent të individëve ndaj të cilëve ushrohet dhunë sistematike ose periodike.

Dhuna në familje

Edhe në Shqipëri, sipas lëvizjes globale Amnesty International, tregohet për një numër të madh të rasteve të dhunës në familje. Mirëpo Shqipëria tashmë e ka Ligjin për Dhunën në Familje, i cili është miratuar nga parlamenti shqiptar në dhjetor të vitit 2006

dhe i cili hyri në fuqi më 1 qershor 2007. Ligji që rezultoi i një fushate të gjatë të zhvilluar nga një koalicion organizatash jo qeveritare (OJQ), që çoi në hartimin e një peticioni për 614 denoncime. Deri në shtator të vitit 2009, ishin bërë rreth 993 denoncime të rasteve të dhunës në familje. Si OJQ-të në Shqipëri, ashtu edhe policia, e interpretojnë këtë rritje si një gatishmëri dhe besim më të madh të grave të keqtrajtuara për të denoncuar dhunën në familje. Denoncimet e bëra në polici përbëjnë vetëm një pjesë të vogël të numrit të vërtetë të rasteve të dhunës në familje. Pjesa më e madhe e grave, sidomos në zonat rurale ku edhe të folurit për dhunën në familje vazhdon të jetë një tabu e fortë, ende ngurrojnë ta denoncojnë dhunën në familje tek autoritetet. Në fund të vitit 2008, në qendra të mëdha urbane dhe rajone policie u krijuan njësi të specializuara policore për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna në familje, por në zonat rurale zbatimi i ligjit dhe informimi për dispozitat e tij është ende i zbehtë. ■



GRUPET SHQIPTARE KONTROLLOJN

Gëzim QERIMI

Vendet e Ballkanit kanë dështuar në luftimin e trafikimit të drogës. Në shtetet e Ballkanit kalojnë mijëra tonë drogë të llojeve të ndryshme. Njëmbëdhjetë shtete të Ballkanit, marrë së bashku, brenda një viti, nuk kanë mundur të konfiskojnë droge sa Turqia vetëm. Kështu thuhet në raportin e vitit 2010 të Zyrës së OKB-së për Drogë dhe Trafikim.

Disa prej shteteve të Ballkanit janë shndërruar në vende transite të trafikut të drogës, që ka si destinacion shtetet e Evropës Perëndimore, e më së shumti, Italinë.

Shtete si Kosova, Maqedonia Shqipëria, Serbia janë pjesë e një zinxhiri të gjatë vendesh nëpër të cilat kalon droga, për të mbërritur deri në shtetet perëndimore, që janë edhe vendet konsumuese të saj.

Kështu thuhet ndër të tjera në një raport të Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Drogë dhe Krime (UNDOC), për vitin 2010.

Sipas këtij dokumenti, vetëm tregu i heroinës në vendet e Evropës Perëndimore është i barabartë me prodhimin e përgjithshëm bruto (GDP) të Kosovës, Serbisë, Maqedonisë dhe Shqipërisë, marrë së bashku, ose në total, 20 miliardë dollarë amerikanë në vit. Megjithatë, në këtë dokument thuhet se të gjitha vendet janë të prekura nga ky lloj trafikimi.

Sipas raportit, tregu i drogës është një kërcënim për vendet e Ballkanit, si për Kosovën, Serbinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Maqedoninë dhe Shqipërinë.

Madje dokumenti përmend edhe arsyet përse trafikimi i drogës është në këtë nivel kaq të lartë.

“Një numër i konflikteve të pazgjdhura ose tensioneve ndëretnike pamundësojnë bashkëpunimin rajonal dhe reagimin urgjent e efektiv për parandalimin e këtij trafikimi”, - shkruhet në këtë dokument. Këtu mund të themi se është fjala për raportet jo të mira të Serbisë me Kosovën dhe Bosnjën dhe Hercegovinën, të cilat faktikisht po e pengojnë edhe luftën kundër drogës.

Duke ofruar ide për zgjidhjen e këtij problemi, raporti përmend së paku një mundësi, të cilën Kombet e Bashkuara mund ta përdorin në luftimin e kësaj dukurie.

Raporti përmend një dokument të Agjencisë për Krime Serioze të Britanisë së Madhe të vitit 2009, ku theksohet se rrjetet e trafikut nga Turqia vazhdojnë të kontrollojnë furnizimin me heroinë të Evropës.

Kjo do të thotë se rrjetet e Turqisë e sjellin drogën deri në kufijtë e Bullgarisë ose Greqisë, ku pastaj kujdesin për të e marrin grupet e Ballkanit. Pavarësisht prej kësaj, shteti turk lavdërohet në dokument për luftën që është duke bërë ndaj drogës, por kritikohen shtetet e Ballkanit. “Relativisht pak është shënuar përparim nga shtetet e Ballkanit në luftimin e këtij trafikimi”, - thuhet në raportin e UNDOC-së.

Madje për këtë jepen edhe shifra. Sipas tyre, në vitin 2008, 11 shtete të Evropës Juglindore, duke përfshirë edhe Greqinë dhe Qipron, nuk kanë mundur as për së afërmi të konfiskojnë lëndë narkotike sa ka bërë Turqia ose edhe Irani.

Thënë më ndryshe, çdo kilogram droge i zënë nga këto shtete, është e barabartë me 6 kilogramë që janë kapur nga Turqia ose 11 kilogram nga Irani.

Madje shumë shtete, me raportet e tyre për konfiskimet e lëndëve narkotike, lënë të nënkuptohet se droga kalon nëpër territoret e tyre, vëren dokumenti.

Si shembull negativ merret Mali i Zi, i cili për tërë vitin 2008, ka kapur vetëm 18 kilogram heroinë, Bosnja e Hercegovina 24 kilogramë, Maqedonia 26, Hungaria 28, Shqipëria 75, Austria 104, Sllovenia 136, Kroacia 153 dhe Serbia 207 kilogram.

Sa u përket rrjeteve të trafikimit, dokumenti thekson se është shumë e qartë se disa prej tyre e kanë ndërtuar hierarkinë në Shqipëri.

“Grupet shqiptare kanë një strukturë të atillë që në mënyrë të veçantë e bën të vështirë infiltrimin. Kjo e shpjegon pjesërisht arsyen përse ata vazhdojnë të kontrollojnë disa tregje të heroinës në Evropë”, - theksohet në dokument. Në raport thuhet se grupet shqiptare janë më të dukshme në Greqi, Itali dhe Zvicër. Madje, Italia vazhdon të mbetet vendi më i rëndësishëm për trafikantët e Ballkanit.

Droga shkatërron brezat e rinj

Nuk ekziston një datë e caktuar për fillimin e përdorimit të drogës në shoqëri. Ekzistojnë dokumentacione që vërtetojnë se njeriu është njohur me fenomenin e drogës 4 mijë vjet më parë. Dijetari romak Pelin, në shekullin e parë, është i pari i cili ka nxjerrë lëngun e hashashit të quajtur opium.



NË TREGJET E HEROINËS NË EVROPË

Sot fenomeni i drogimit ka përfshirë lindjen dhe perëndimin, të pasurit dhe të varfrit, duke u kthyer në një kërcënim serioz për shoqërinë

Sipas statistikave të OKB-së, sot në botë ekzistojnë 250 milionë persona të droguar. Nuk ka dyshim se shtimi i konsumit dhe i qarkullimit të parave të lëndëve narkotike, ndikon në shtimin e trafikimit dhe prodhimit të këtyre lëndëve. Tregtia e lëndëve narkotike, pas tregtisë së naftës dhe armëve, është tregtia më fitimprurëse në botë dhe në këtë tregti janë aktivizuar një numër i madh bandash mafioze.

Vitet e fundit përfituesit e këtij tregu, duke ndryshuar llojin e konsumit të lëndëve narkotike, filluan prodhimin e llojeve të ndryshme të tyre.

Sot përdorimi i lëndëve narkotike është duke ndryshuar formën, nga ajo tradicionale në atë industriale. Përdoruesit e lëndëve narkotike në formën tradicionale janë ata që përdorin kokainën, heroinën, hashashin, morfinën etj, të cilët përbëjnë 10-20% të përdoruesve të lëndëve narkotike në botë. Pjesa tjetër prej 80% e konsumatorëve të lëndëve narkotike përdorin ilaçe qetësuese dhe stimuluese, të cilat gjenden sipas kushteve ekonomike shoqërore dhe politike

të vendeve të ndryshme. Përdorimi i këtyre ilaçeve, në perëndim dhe në Amerikë, gjatë 10 viteve të fundit, është rritur 10 herë.

Shtimi i përdorimit dhe konsumimit të lëndëve narkotike është duke e vënë në rrezik serioz shoqërinë njerëzore. Konsumi më i madh i pilulave stimuluese është në shtresat shoqërore të moshës 17- 28 vjeçare. Sigurisht, kjo nuk nënkupton se shtresat e tjera të shoqërisë nuk përballen me rrezikun e lëndëve narkotike.

Tregtarët e vdekjes

Tregtarët e vdekjes, për të plotësuar interesat e tyre çnjerëzore, nuk heqin dorë nga asnjë element i shoqërisë dhe grupet e shtresave shoqërore në moshë të njomë janë grupet e preferuara prej këtyre personave gjakpirës. Të rinjtë, për shkak të shpirtit të tyre kurioz, të pavarur, entuziast dhe ndjekës të të mëdhenjve, përbëjnë shtresën më të ndjeshme në çështjen e përdorimit të lëndëve narkotike. Për këtë arsye, vendet e botës së tretë, duke pasur një numër të madh të rinjsh, përbëjnë një treg të favorshëm për trafikantët e lëndëve narkotike. Këta trafikantë, duke shfrytëzuar mungesën e njohurive dhe problemet e të rinjve, përpiqen të shtrijnë aktivitetet e tyre në shpërndarjen e drogës, duke shtuar numrin e viktimave të këtij fenomeni. Fëmijët e moshave të ndryshme, gjithashtu, mund të bien në kurthin e trafikantëve të lëndëve narkotike. Fëmijët e familjeve në të cilat përdoren lëndët narkotike, ose janë të përfshirë në këtë tregti të pistë, gjithashtu janë fëmijë që shfrytëzohen nga bandat e lëndëve narkotike. Me plot gojë mund të themi se sot përdorimi i drogës është kthyer në një kërcënim serioz për njerëzimin dhe sidomos për brezat e rinj. Ky fenomen, përveç ndikimeve shkatërrimtare të tij, sjell edhe shumë dukuri të fshehta dhe sëmundje të ndryshme si: sida, hepatiti dhe shumë sëmundje të tjera. Metoda dhe përdorimi i lëndëve narkotike dhe i drogës në shoqëri është aq i rrezikshëm, saqë është kthyer në një nga sfidat dhe problemet kryesore të njerëzimit dhe shumë nga krimet në shoqëri lidhen pikërisht me fenomenin e drogës. Çdo person, i cili konsumon drogë, mendon për plotësimin e dozave të tjera

dhe shtresat me të ardhura të pakta nuk gjejnë rrugë tjetër veçse t'i futen rrugës së krimeve. Në këtë mënyrë, drogimi është fillimi i krimeve të tilla si vjedhja, vrasja, tradhtia, si dhe shumë krime personale dhe shoqërore. Për t'u përballur me këtë fenomen shkatërrimtar, më shumë se kurrë është e nevojshme njohja e të rinjve me efektet negative të drogës. Kontrolli i përshtatshëm i prindërve dhe njohja e të rinjve me dëmet e drogës, janë ndër rrugët më efektive të parandalimit të përdorimit të lëndëve narkotike. Të rinjtë duhet ta dinë se përdorimi i lëndëve narkotike, qetësuese dhe stimuluese dhe entuziaste, në radhë të parë, vë në rrezik shëndetin fizik të tyre dhe në radhë të dytë mund t'i përballë ata me vdekjen. Një tjetër dëmtim që vjen si rezultat i përdorimit të lëndëve narkotike është stresi, depresioni, pagjumësia dhe çmenduria.

Sociologët, duke vënë theksin në rolin jashtëzakonisht të madh të familjes në parandalimin e përdorimit të lëndëve narkotike, janë të mendimit se edhe organet përkatëse të shtetit duke zbatuar detyrat dhe përgjegjësitë e tyre mund të luajnë një rol tepër të madh në eliminimin e plagëve të shoqërisë, një prej të cilave është edhe përdorimi i lëndëve narkotike. Krijimi i vendeve të punës, vendosja e kushteve të barabarta dhe të drejta për të gjithë shtresat e shoqërisë, programi i kohës së lirë të të rinjve, informimi i gjerë publik dhe dhënia e informacioneve të nevojshme nëpër librat shkollorë, si dhe lufta serioze kundër elementëve keqdashës në shoqëri, janë ndër rrugët e parandalimit të ndotjes së të rinjve me fenomenin e drogës dhe lëndëve narkotike. Për lartësimin e shkallës së shëndetit të shoqërisë të gjitha shtetet dhe organizatat ndërkombëtare duhet të bashkëpunojnë më njëra-tjetrën në mënyrë që të parandalojnë zhdukjen e brezit të ri, i cili është kapitali më me vlerë për të ardhmen e njerëzimit. Ky bashkëpunim, duke përdorur rrugëzgjidhje shkencore dhe ekzekutive, mund të parandalojë zgjerimin e fenomenit të drogimit dhe devijimit të shoqërisë. Rolin vendimtar për parandalimin e devijimit të shoqërisë e ka feja islame, e cila i lufton të gjitha dukuritë negative dhe e frymëzon gjithmonë njerëzimin për humanizëm dhe bamirësi. ■



VESHJET SHQIPTARE -

Veshja tradicionale shqiptare po “jeton” një kohë jo aq të lavdishme siç e meriton ajo në të vërtetë. Mes lashtësisë e modernes, duket sikur veshjet kombëtare janë mbuluar nga pluhuri i harresës

Blerta BREZNICA

Dikur të pandashme nga jeta e njerëzve, sot ato mund t'i shohim vetëm në panairë, në manifestime të ndryshme e diku edhe në dasma. Këto të fundit, duket sikur i kanë dhënë jetë më shumë bukurisë së veshjeve shqiptare. Hijerëndë, veshja kombëtare ka shoqëruar shqiptarët në lufta, në dasma, në ditë zie e lumturie. E sotmja e gjen të mbyllur në sepete të disa familjeve që e ruajnë me fanatizëm veshjen identifikuese të shqiptarëve. Dikur e pashmangshme në jetët tona, e sidomos në dasma, sot ajo është tretur në harresën e gjyshërve tanë. Tek-tuk sot mund ta hasë njeriu në dasma veshjen shqiptare.

Në panairin e fundit të artizanaleve, u prezantuan shumë organizata joqeveritare, të cilat punojnë me vite veshje kombëtare. Xhyllshahe Berisha nga Qyshku i Pejës thotë se është rritur me këto veshje dhe qysh në fëmijëri ka mësuar t'i punojë ato.

“Ne e kemi trashëgimi këtë punë. Vjehri im ka jetuar 110 vite dhe ka kultivuar tirqit dhe veshjen kombëtare. Ashtu edhe vjehrra dhe nëna ime. Prej moshës 14 vjeçare më ka mësuar të punoj në vegjë. Kam punuar qilima, pëllhurë e shumë gjëra të tjera, të gjitha me vegjë”, - thotë Xhyllshahja.

Viteve të fundit sikur pati një “zgjim” të njerëzve rreth rëndësisë që kanë këto veshje. Fundja, ato përfaqësojnë identitetin tonë kombëtar. Po humbëm edhe identitetin, jemi të humbur.

Mërgimtarët tanë janë ata që ndoshta më së shumti e ndiejnë nevojën e këtyre vlerave, për t'i pasur ato në qytetet evropiane ku jetojnë. Pak kulturë shqiptare me vete, i bën ta ndiejnë më afër vendin.

Etnologia Zanita Halimi mendon që veshja tradicionale shqiptare jeton në popull, pavarësisht që tani e gjejmë të pranishme në forma të ndryshme. “Nuk mund të thuhet se veshjet



TRADITA NË HARRIM

shqiptare po zhduken. Jeta e tyre po vazhdon në mënyra të ndryshme, tani jo në mënyrë aktive, po në raste të caktuara. Veshja tani bartet në raste ceremoniale, martesore, në raste të ndryshme festive, rituale, në takime të organizuara zyrtare, ose private, në përvjetorë e tjera. Paraqitjen dhe bartjen e veshjeve në këto raste populli e koncepton si ruajtje të traditës, të identitetit kombëtar”, - thotë Zanita Halimi.

E bukur, e veçantë, krenare, veshja tradicionale shqiptare sikur mbart në vetvete gjithë historinë tonë ndër vite. Fustanella, tirqit, opingat, jelekët, xhamadanët, xhubletat, shajakët, brakeshat, cibunet e shumë të tjera janë disa nga elementet kryesore të veshjeve shqiptare. Të dallueshme edhe sipas krahinave, ato janë identiteti jonë “në zhdukje”.

Që veshja shqiptare ka qenë dhe mbetet një nga veshjet më të bukura dhe karakteristike të kohës, këtë e thotë edhe etnologja Zanita Halimi. “Gjatë historisë elementet simbolike dhe tiparet krahinore stabilizohen dhe ngrihen në shkallë kombëtare. E këtillë është veshja me fustanellë e cila arriti që të cilësohet dhe të veçohet nga të huajt si veshje e “modës shqiptare”. Po ashtu, edhe në pjesë të ndryshme të veshjeve vendosen motive të shqiponjës së zezë dy krenare në sfond të kuq, që reflekton përkatësinë etnike kombëtare shqiptare.”

Për veshjet shqiptare kanë shfaqur interesim edhe të huajt, konkretisht ndërkombëtarët që kanë vizituar Kosovën për punë dhe për qejf. Seç të tërheq me motivet, ngjyrat dhe materialet veshja jonë e s'i reziston dot askush. Plisi, simboli i burrave, pleqësisë e mençurisë, ka qenë dhe mbetet një nga pjesët më të bukura të tradicionales sonë. I ekspozuar edhe në muze e ekspozita të ndryshme të botës, plisi ose qeleshja vazhdon të identifikojë shqiptarët në botë edhe sot.

Kontributin e institucioneve tona të kulturës në ruajtjen dhe promovimin e këtyre vlerave të veshjes kombëtare shqiptare, Zanita Halimi nuk e konsideron të mjaftueshëm. “Institucionet e kulturës nuk po kontribuojnë sa duhet dhe sa është e nevojshme për promovimin si dhe stimulimin e punimit të veshjeve dhe promovimin e kulturës në përgjithësi. Përveç organizimit të disa ekspozitave që kanë për qëllim prezantimin e veshjeve dhe kulturës, institucionet e kulturës duhet të punojnë më tepër në hapjen e muzeumeve në qytetet, të cilat nuk kanë, si dhe hartimin e politikave lokale për promovimin, prezantimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore. Në këtë mënyrë edhe veshjet do të zënë vendin e merituar”.

Sot rrotës se historisë s'ia zëmë dot hapin. Ajo



ecën shpejt e pamëshirë, duke marrë kështu me vete edhe gjërat më të çmuara që kemi. Epoka e digjitalizimit na vjen para si një dinozaur i pamëshirshëm dhe po të mos i kemi rrënjët e forta mund të na shkulë fare. Dhe këto rrënjë, pa dyshim, na i përfaqëson historia dhe kultura jonë kombëtare. ■

Kuvendi Komunal i Prishtinës: “Nuk ka vend për ndërtimin e një xhamie të madhe në Prishtinë”



MUNGOJNË XHAMITË - XHEMATI NË RRUGË

Hekuran AVDYLI

Edhe pse me përqindjen më të lartë të numrit të popullsisë (mbi 95 për qind), komuniteti musliman në Kosovë i mohohen shumë të drejta, madje edhe nga ato më elementaret, siç është posedimi i një qendre të mirëfilltë islame në të cilin muslimanët do të mund t'i kryenin më me lehtësi ritet dhe aktivitetet e tjera fetare.

Njëmbëdhjetë vite pas përfundimit të luftës në kryeqytet, besimtarët muslimanë janë të detyruar t'i kryejnë obligimet e tyre fetare në rrugë dhe në kushte shumë të vështira, në mungesë të një xhamie të madhe, e cila do të përmbushte nevojën e shumë qytetarëve, sidomos në faljen e namazit të xhumasë, ditë në të cilën po të kalosh rrugëve, të cilat kanë afër xhamitë, do të hasësh në shumë njerëz të cilët në mungesë të hapësirës në xhami janë të detyruar të kryejnë namazin në rrugë, duke shtruar ndonjë shtroje, ose edhe asgjë!

Në lidhje me mungesën e një xhamie, ose qendre më të madhe islame, ka reaguar shumë herë edhe Bashkësia Islame e Kosovës, duke dërguar kërkesa në Kuvendin Komunal për dhënien e një hapësire të arsyeshme për ndërtimin e një xhamie të madhe, kërkesa, të cilat kanë hasur në vesh të shurdhur, pasi që deri tani nuk është ndarë tokë për ndërtimin e xhamisë.

Kryeimami i Kosovës, myftiu Naim Tërnavë, bëri të ditur se herën e fundit që ka dorëzuar kërkesë me shkrim në

kuvendin komunal për dhënien e një terreni të përshtatshëm në kryeqytet për ndërtimin e një xhamie, ka marrë përgjigje negative nga komuna.

“Kërkesa për ndërtimin e një xhamie në vendin ku momentalisht është ombudspersoni i Kosovës, është refuzuar nga kuvendi komunal, ndërsa pas kësaj kemi dorëzuar përsëri kërkesë për dhënien e ndonjë terreni tjetër në Prishtinë, për çka kuvendi komunal na kanë thënë se në Prishtinë nuk ka vend për ndërtimin e një xhamie të madhe”, - tha myftiu Tërnavë.

Në këtë mënyrë i trajton kuvendi komunal i Prishtinës kërkesat e komunitetit musliman, ose thënë më mirë kërkesat e atyre, të cilët me votat e tyre i sollën aty ku janë.

Në anën tjetër, në kryeqytet mund të gjendet hapësirë për çfarëdo tjetër, përveç për ndërtimin e një xhamie të madhe. Komuniteti katolik, i cili në Kosovë përbëhet nga jo më shumë se 3 për qind e popullsisë, gëzon të drejtën e posedimit të një qendre gjigante në mes të Prishtinës, ndërsa besimtarët muslimanë i kryejnë obligimet e tyre në shi, në qiellin e hapur. Arsyeja e dhënë nga Kuvendi Komunal, për mosposedimin e hapësirës në Prishtinë, nuk qëndron pasi që në disa pjesë të qytetit ka hapësira të lira.

Sa për ilustrim në kryeqytetin e Anglisë, në Londër, mund të hasësh në shumë qendra, të cilat janë shumë më të mëdha e më konforme se xhamitë në Prishtinë. I habitur nga kjo situatë

në Prishtinë është edhe Mark Lowen, gazetar i BBC-së, i cili ishte në Kosovë dhe pati rastin të shihte gjendjen e muslimanëve në ditën e xhuma të Xhamia e Llapit në Prishtinë, ku qytetarët po faleshin në trotuare në mungesë të hapësirës, e ku filloi edhe një shi i furishëm, nën të cilin muslimanët ishin të detyruar të faleshin në mungesë të hapësirës brenda në xhami.

“Më ka shokuar ajo gjendje. Në Londër nuk është se ka numër aq të madh të muslimanëve, por ata i kanë vendet e tyre shumë më të përshtatshme sesa këtu për kryerjen e ritualeve të tyre”, - tha Mark Lowen, pas fotografive që iu bëri qytetarëve të cilët faleshin të Xhamia e Llapit, në shi.

Për Anglinë, vend ky nga më të zhvilluarit në Evropë në shumë aspekte, nuk paraqet ndonjë pengesë ndërtimi i qendrave islame në të cilat ata që duan mund të zhvillojnë jetën e tyre në mënyrën që ata zgjedhin, përderisa në Kosovë fatkeqësisht nuk është kështu. Myftiu Naim Tërnavë na bëri të ditur se disa herë ka pasur donatorë të cilët kanë qenë shumë të interesuar për investim në projektin për ndërtimin e një qendre të madhe islame në Prishtinë, por deri tani asnjëri nuk ka mundur të shfrytëzohet në mungesë të lejes nga komuna.

Edhe këtë ramazan, muslimanëve u mbetet të vazhdojnë të falen në xhami të vogla, e në rrugë dhe po ashtu ju mbetet vetëm shpresa dhe lutjet që në një të ardhme të respektohen më shumë kërkesat dhe të drejtat e tyre. ■

Qytetarët e komunës së Rahovecit ndërtuan edhe një xhami në qendër të qytetit

RAHOVECI ME XHAMI TË RE

Në qytetin e Rahovecit është ndërtuar edhe një xhami. Për të ndërtuar këtë xhami një kontribut të madh kanë dhënë vetë qytetarët e këtij vendi. Xhamia e re, që mban emrin e xhamisë së vjetër “ Kadiri”, është njëra nga pesë xhamitë që ka ky qytet, e që janë të mjaftueshme për t’u kryer obligimet fetare.

Bujar ISMA


Ditë më parë, në qytetin e Rahovecit përfunduan punimet e xhamisë më të re të qytetit, xhamia Kadiri. Sipas kryemamit të Bashkësisë Islame, dega në Rahovec, Nysret Abazibra, këto punime kanë shkuar shumë mirë duke mos pasur asnjë problem që nga fillimi e deri në përfundimin e xhamisë. “ Punimet kanë shkuar mirë, probleme nuk kemi pasur nga askush, kështu që çdo gjë ka shkuar në rregull”, - ka thënë Abazibra. Sipas tij, për ndërtimin e kësaj xhamie të gjitha të ardhurat kanë qenë nga xhemati i Rahovecit, të cilët në çdo kohë kanë kontribuar në ndërtimin e kësaj xhamie. Bashkësia Islame është mirënjohëse për solidaritetin që ka treguar popullata e komunës së Rahovecit, ndërsa kuvendi komunal, përveç përkrahjes morale, nuk ka dhënë ndonjë shtesë materiale, megjithëse nuk i është kërkuar. Në lidhje me këtë, kryemami Abazibra shprehet: “E gjithë xhamia që nga fillimi e deri në përfundim është financuar nga ana e xhematit, ndërsa komuna nuk na ka ndihmuar aspak, por sidoqoftë, ne jemi të kënaqur me komunën ngase nuk na ka penguar asnjëherë në punët tona”, - ka theksuar Nysret Abazibra. Kryemami Abazibra

thotë se nuk ka pasur asnjë mundësi që të bëhet restaurimi i xhamisë së vjetër pasi që ajo ishte e ndërtuar me material të dobët nga balta dhe rrezikonte qarkullimin qytetarëve, duke theksuar se ka pasur raste, që nga minarja e dëmtuar nga koha e luftës, kanë rënë disa herë pjesë që kanë mundur t’i lëndonin qytetarët, prandaj është marrë vendimi nga Këshilli i Bashkësisë Islame, në mbështetje me xhematin, për të ndërtuar një xhami të re. “ Edhe nëse ne kemi dashur të bëjmë ndonjë restarurim, ajo ka qenë e pamundur për arsye se nuk ka pasur kurrfarë vlere. Prandaj është dashur intervenimi i menjehershëm që të ndërtohet xhamia e re” -shtoi ai.

Xhamia e vjetër datonte nga viti 1750 dhe kishte hapësirë 6 metra me 8, ku mund të faleshin rreth 70 persona, ndërsa në maj të vitit 2006 u mor iniciativa për prishjen e kësaj xhamie, për të ndërtuar një xhami të re që do të plotësonte kushtet më të mira për të kryer ritet fetare. Xhamia e re e quajtur “Kadiri” tani posedon katin e parë në të cilin mund të falen rreth 200 persona, si dhe ballkonin që ka mjaft hapësirë për t’u falur xhemati i kësaj xhamie, ndërsa imam i kësaj xhamie është Adnan Pallqa. Xhaminë e re e vizitojnë qytetarë nga të gjitha viset e Kosovës, por edhe nga jashtë. ■



Xhamia e vjetër



Xhamia e re


Çështja e moralit dhe e normave

Milazim MUSTAFA

Normat morale janë një lloj i normave shoqërore, por në të njëjtën kohë edhe formë e vetëdijes njerëzore. Morali është i përbërë nga norma të krijuara në vetëdijen e njerëzve, norma këto të formuara nga bindja vetjake e së mirës dhe së keqes. Në bazë të këtyre bindjeve personale njeriu si individ sillet në shoqëri, pa marrë parasysh se a bën mirë a keq, a është ndërgjegjja e tij e qetë dhe e rehatshme, a do ta brejë ndërgjegjja e tij, apo a do të jetë i dënuar nga shoqëria. Përveç këtyre ekzistojnë edhe sanksione të tjera morale si pendimi, i cili në disa raste është aq i madh saqë mund të shpie edhe në marrjen e jetës si sanksion i brendshëm, por edhe ato të jashtme si urrejtja, lëçitja e kështu me radhë. Për të bërë një dallim nga normat zakonore (traditat), normat morale nuk formohen nga përsëritja e gjatë e ndonjë sjellje ose veprimi, por në bazë të bindjeve të tyre personale, si dhe në analizimin e vazhdueshëm të vetvetes rreth asaj që bëhet, se a është e mirë a e keqe.

Normat morale dallojnë edhe nga ato juridike, pasi që normat juridike paraqiten me paraqitjen e shtetit, kurse ato morale ekzistojnë prej shoqërisë parahistorike. E drejta ose normat juridike janë norma saktësisht të caktuara, kurse normat morale kanë një strukturë shumë më të ndërlikuar. Pas normave juridike qëndron shteti dhe aparati shtetëror, kurse morali realizohet në bazë të shprehive personale si rezultat i gjykimit të vetëdijshëm dhe fuqisë së mendimit shoqëror e kështu me radhë. Morali përmban tradita të caktuara, rregulla, rregullore, ndalesa, norma, kategori, ideale, të gjitha këto për dallim nga normat juridike dhe ligjore (që janë të shkruara). Këto janë norma jo të shkruara dhe individëve ose grupeve të tëra iu imponohet respektimi i këtyre normave, qofshin këto të lidhura me formën e jetesës, sundimit, sjelljes, gjykimit ose vlerësimit.

Sa i përket normave morale, këto me kalimin e kohës edhe ndryshojnë.



Bie fjala, me ndryshimin e faktorëve të jashtëm arrihet edhe deri te ndryshimi i rolit, përmbajtjes dhe përfshirjes që e kanë këto norma. Gjithashtu, normat morale nuk janë të njëjta në të gjitha shoqëritë. Për një grup të caktuar shoqëror, një normë që llogaritet morale, për një grup tjetër mund të jetë amorale.



Mirëpo shtrohet pyetja se sa respektohen normat morale në ditët e sotme në shoqërinë tonë shqiptare. Këtu nisemi nga bindja dhe fakti se këto norma ditëve të sotme janë zbehur dhe, ditë pas dite, kemi zhvlerësim të këtyre normave, si rezultat i rënies së sistemit të vlerave në përgjithësi.


Sa i përket kësaj, hoxhë Imer Mustafa na shpjegon se ditëve të sotme, për dallim nga e kaluara e afërt, interesi dhe përfillja e këtyre normave është shumë e ulët. Për njerëzit, në ditët e sotme, në të shumtën e rasteve (edhe pse gjithmonë duhet të kemi parasysh se kemi përjash-time) këto norma kanë shumë pak vlerë. "Kemi shumë raste, kur nëse nuk frikësohen prej sanksioneve penale ose kundërvajtjeve, nuk i bren aspak ndërgjegjja ose nuk duan të dëgjojnë për sanksionet e tjera morale, që në të kaluarën kanë qenë shumë të çmuara dhe të dobishme në shoqërinë tonë shqiptare. Faktikisht, me dekada këto norma e kanë mbajtur gjallë shoqërinë tonë, por, në të njëjtën kohë, e kanë mbajtur edhe rendin shoqëror. Sidomos në

pjesët shqiptare ku kanë qenë të lëna anash nga pushteti, shumë çështje janë rregulluar në bazë të këtyre normave, respektivisht në bazë të formulës se një punë nuk duhet të bëhet, sepse është punë e keqe dhe anasjelltas. Njerëzit, kanë qenë të privuar nga veprimi i punëve të ndryshme si rezultat i ekzistimit të ndërgjegjes se një punë e tillë nuk bën të veprohet dhe janë ruajtur nga ajo punë apo vepër. Kurse, ditëve të sotme, edhe pse kemi një përkujdesje më të madhe të aparatit shtetëror, kemi më shumë ligje dhe rregullativa, prapëseprapë, këto nuk ndikojnë në parandalimin e veprave jo të hijshme që llogariten si amorale në shoqërinë tonë. Ta marrim një shembull. Në të kaluarën, ka qenë e pamendueshme që një femër shqiptare të zbulonte një pjesë të trupit, kurse sot, femrat tona shqiptare bëjnë punë edhe shumë më të pahijshme se kjo, shesin nderin e tyre, bëjnë publikisht vepra jo të hijshme e kështu me radhë. Ne si hoxhallarë, kemi pasur raste të shumta ku kemi qenë të thirrur të ndërmjetësojmë

Norme morale në shoqërinë tonë



në konteste dhe konflikte të shumta që ndodhin në shoqërinë tonë. Fatkeqësisht, hasim gjithnjë e më shumë në raste ku nëpërkëmbet morali dhe nderi i njerëzve, sidomos i femrave të reja që sot prej subjektit janë shndërruar në objekt. Morali, sot, ka shumë pak vlerë në shoqërinë tonë. Janë të shumta rastet ku nuk përfillen aspak dëmet që shkaktojnë dëmtim të moralit të një individi, kryesisht njerëzit interesohen për anën materiale, kurse për atë morale që ka të bëjë me anën e brendshme, ose atë shpirtërore nuk interesohen aspak. Këtu ka rol të madh edhe çështja e imanit ose besimit, që është e lidhur shumë ngushtë



Burim Rrustemi

me moralin”, - shprehet hoxhë Imeri.

Sa i përket kësaj, juristi Burim Rrustemi, deklaron se qëllimi i sanksioneve dhe normave juridike mes të tjerash është edhe edukimi i popullatës. Në të shumtën e rasteve, gjatë sjelljes së akteve të shumta juridike, nuk shikohet aspak ana edukative e këtyre akteve, më konkretisht nuk proklamohet dhe propagandohet aspekti edukativ dhe moral i ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore. Nuk tregohet se këto vepra nuk duhet të bëhen për shkak se nuk është mirë të bëhen, por të mos bëhen sepse për ato pason një dënim i caktuar, sepse kjo ka ndikim të madh, sidomos në aspektin psikologjik të qytetarëve. Organet shtetërore, përveç se duhet të përkujdesen për mbajtjen e rendit dhe qetësisë në një shoqëri, ato duhet të përkujdesen edhe për anën shpirtërore, sepse morali është i lidhur me të drejtën, ose të shprehem edhe më direkt, morali është ai gjë që i jep shpirt drejtësisë.

Në bazë të kësaj mund të konstatojmë se rëndësia e normave morale në një shoqëri është tejet e madhe. Secili grup shoqëror duhet të mbështetet patjetër në parime të caktuara morale. E njëjta gjë vlen edhe për veprimet individuale, por edhe për lidhshmërinë

e moralit me të drejtën dhe drejtësinë, konkretisht për rritjen e efikasitetit të kësaj të fundit, problem ky që realisht shkakton kokëçarje në shoqërinë tonë në përgjithësi.

Në bazë të gjithë kësaj potencojmë edhe rëndësinë e edukimit moral nëpër institucionet edukativo-arsimore. Është shumë e logjishme se kur një problem detektohet si i tillë, duhet të pasojë edhe të marrit me atë problem, duke tentuar që ai të parandalohet dhe shërohet, e jo t'i kontribuohet rritjes së tij. Ne, sot, të gjithë jemi të bindur se kemi të bëjmë me rënien e vlerave morale, andaj i përkujtojmë institucionet tona që të kenë një përkujdesje më të madhe për këtë problematikë. Mjet efikas për këtë çështje mund të jetë edhe futja e edukimit fetar (mësim besimit) nëpër shkollat fillore dhe të mesme, sepse për forcimin e normave morale, rol të madh luan edhe feja. Ne e dimë se feja në esencë, përveç anës së besimit në Zot, fton edhe për ngritjen dhe respektimin e normave morale. Mes të tjerash kjo mund të llogaritet edhe si masë preventive për forcimin dhe ngritjen e vlerave morale në shoqërinë tonë ku padyshim se të gjithë jemi të mendimit se këto vlera janë në rënie e sipër. ■

Me fat muaji i bekuar i Ramazanit!

Me fat muaji





kuar i Ramazanit!

فَصَلِّ لِرَبِّكَ
إِذَا قَامَ

EDHE ME BLOKADA TË GJI

Intervistoi: Iljasa SALIHU

Prefekti i komunës së Gostivarit, Rufi Osmani, në intervistën ekskluzive dhënë revistës Paqja, në mes tjerash flet edhe për atë se përse është përcaktuar të formojë parti politike në një ardhme të afërt. Ai gjithashtu flet edhe për tema e probleme të ndryshme që preokupojnë popullatën shqiptare në Maqedoni.

PAQJA: Fillimisht i nderuar kryetar i Komunës së Gostivarit, a mund të na thoni diçka se si vejnë punët gjatë mandatit tuaj si kryetar i zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejtë prej popullit? A hasni në pengesa kur bëhet fjalë për ndonjë investim që duhet të përkrahët prej partisë shqiptare në pushtet?

z. Rufi Osmani: Rezultatet e punës sime njëvjeçare janë pa diskutim pozitive, duke pasur parasysh problemet e shumta me të cilat u ballafaqova dhe, në veçanti, me borxhet e trashëguara prej mbi 10 milion euro, administratë komunale të politizuar dhe mjaft të korruptuar, urbanizëm që ishte peng i mafisë urbane politike, bllokadat permanente nga institucionet qendrore dhe ndërmarrjet publike komunale para bankrotit. Problemet janë të shumta dhe në veçanti komuna që udhëhiqet nga unë si kandidat i pavarur është përfshuar tërësisht nga investimet publike në infrastrukturë, arsim, kulturë dhe nga burimet e jashtme financiare që monitorohen nga pushteti qendror.

Komunikimi me qeverinë ka qenë shumë i vështirë, sa që në muajt e fundit është bllokuar në tërësi. Një bllokadë e kësaj natyre është karakteristikë në veçanti me ministrin e ekologjisë, financave, transportit, bujqësisë, punëve të brendshme dhe fondeve kryesore qeveritare. Rezultatet e arrira kanë realizuar, pjesërisht, objektivat e programit tim paraelektoral. Vitet e mbetura të qeverisjes jam i sigurt se do të paraqesin rezultate më pozitive.

PAQJA: Ku qëndron urtësia e themelimit të shumë partive politike në një shtet të vogël, por me probleme të ndry-

shme dhe të mëdha. Ideja për themelimin e një partie politike shqiptare, është si rrjedhojë e aktualitetit tejet të zymtë që e ka mbërthyer vendin tonë, apo një ide të tillë e keni pasur që moti, duke e pritur kështu "ditën e artë" kur shqiptarët ta shohin veten përballë shtigjeve pa shtegdalje?

z. Rufi Osmani: Ballkani dhe Maqedonia janë vende të paradokseve të mëdha dhe shqiptarët nuk bëjnë kurrfarë përjashtimi. Vrojtimet anësore intelektuale dhe publicistike udhëhiqen nga urtësia që ju përmendni, mirëpo praktika dhe, në veçanti, pragmatizmi politik priret nga parime të tjera. Situata aktuale në Maqedoni nuk dallon aspak nga periudha e deritashme 20 vjeçare transitore, me disa trende shtesë të përkeqësimit. BDI-ja, si pjesë e qeverisë Gruveski, pa diskutim, sot është sinonim i një strukture politike tepër të korruptuar dhe institucionalisht të dështuar në realizimin e Marrëveshjes së Ohrit, strukturë që ka faje objektive për pësimin (vrasjen) e mbi 300 shqiptareve, që kryesisht ishin ish-luftëtarë të UÇK-së dhe strukturë që devalvoi në tërësi ligjin për amnisti si kompensim për sigurinë personale të ish-udhëheqësve të luftës së 2001-shit.


Kjo gjendje ka shumë ngjashmëri me situatën e viteve 1994, 1997 dhe 2008. Kjo situatë reflekton dezorganizimin e

plotë politik, përçarjen ekstreme politike, pafuqinë institucionale dhe politike të subjekteve politike dhe të shqiptareve si popull në tërësi, në të gjitha drejtimet.

Opozita shqiptare e identifikuar me PDSH dhe DR, e disa parti marginale vuajnë nga sindroma e njëjtë nga e cila vuan edhe "pushteti" shqiptar. Një situatë e kësaj natyre nuk le hapësirë të indiferentizmit dhe pasivizmit. Duhet të bëhen përpjekje shtesë të rigrupimit dhe riorganizimit politik. Në sistemet demokratike këto ndryshime mund të bëhen vetëm nëpërmjet konkurrimit demokratik, në të kundërtën do të ngelim në nivelin e disa analistëve dhe intelektualëve të sojit të Kim Mehmetit dhe të ngjashmëve, të cilët shesin shumë mend dhe bëjnë shumë kritika, por praktikisht nuk kanë guxim dhe kapacitet të bëjnë praktikisht diçka konkrete.

PAQJA: Çfarë karakteri do të ketë partia, bartës të së cilës jeni ju, karakter qytetar apo kombëtar? Ku mendoni se partia juaj në aspekt të programit dhe platformës politike do të dallojë nga partitë e tjera, që aktualisht veprojnë në këtë shtet?

z. Rufi Osmani: Në parim, në bazë të bindjeve politike dhe ekonomike që unë dhe bashkëmendimtarët përkrahim, programi do të jetë i spektrit të qendrës së djathtë. Në plan politik do



THANSHME ARRIN SUKSESE

të përkrahim idenë që kombi shqiptar të jetë kombi i dytë shtet-formues dhe gjuha shqipe të jetë gjuhë e dytë zyrtare në nivel shtetëror, të ngrihet në mënyrë cilësore dhe gjithëpërfshirëse autonomia lokale, të kemi ndarje adekuate të buxhetit shtetëror në pjesën e investimeve publike dhe për pjesëmarrjen adekuate në administratën publike, miratimi i vendimeve strategjike të bëhet me parimin e konsensusit në lëmenjtë me interes kombëtar dhe shtetëror për të gjitha bashkësitë etnike .

Në plan ekonomik dhe institucional do të përkrahim funksionimin e ekonomisë së tregut të lirë, reformimin permanent dhe ndërtimin e institucioneve publike të depolitizuara, luftimin konsekuent të krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe përsheptimin e procesit të integritetit euroatlantik të vendit.

Realizimi i objektivave të përmendura më lart, do të varet në masë të konsiderueshme nga uniteti dhe pesha politike e faktorit shqiptar dhe nga përparimi i agjendës integruese të vendit. Sot është e pamundur që një parti politike shqiptare, pavarësisht nga pesha politike që ka, t'i realizojë vetë këto objektiva madhore sepse kjo aspiratë nuk përkrahet nga faktori politik maqedonas. Nevojitet unitet politik, unitet ky që sot është më larg se në periudhat paraprake. Pavarësisht nga sfidat aktuale dhe në perspektivë ky është një amanet, të cilin duhet ta realizojë patjetër kjo gjeneratë e politikanëve dhe intelektualëve shqiptarë në Maqedoni.

PAQJA: Çfarë zgjidhje konkrete do të ofrojë partia juaj ndaj qytetarëve shqiptarë, duke marrë parasysh problemet dhe padrejtësitë e shumta që mbretërojnë në vendin tonë? A do të mundnim që të jetojmë ndonjëherë në paqe të plotë me maqedonasit, duke pasur parasysh marrëdhëniet shekullore të brishta me sllavët, si dhe në mungesë të këtij mirëkuptimi shumetnik, cila është zgjidhja?

z. Rufi Osmani: Ekzistojnë zgjedhje konkrete për shumë probleme të aspektit ekonomik dhe social. Zgjidhja do varet nga pesha politike, kuadrot që do na përfaqësojnë, resurset publike në dis-



ponim, përfundimi i krizës ekonomike, përparimi i procesit të integritetit dhe mundësia e shfrytëzimit të sa më shumë parave nga fondet evropiane dhe investitorët e huaj. Mozaiku është mjaft i komplikuar dhe, për pasojë, alternativat do jenë mjaft të kufizuara, ka varfërime të shpejta dhe procesi i begatimit është shumë i ngadalshëm.

Po, raportet tona me maqedonasit kanë qenë konfliktuale dhe vazhdojnë të karakterizohen nga brishtësia edhe aktualisht. Ky fat është përcaktuar nga gjeografia politike dhe ne duhet të ballafaqohemi me të. Mendoj se ne, si shqiptarë, kemi përvoja shembullore të koekzistencës fetare, po pse jo edhe ndëretnike. Këto vlera duhet t'ua ofrojmë edhe të tjerëve tashmë, ku në nivel ballkanik kemi peshë specifike shumë më të madhe në raport me të shkuarën.

Kur e shtojmë këtë dilemë nuk duhet të heqim nga mendja gjeografinë tonë kombëtare, e cila thotë se jemi komb shumë-fetar, nga tre anë rrethohemi me ortodoksët sllavë dhe grekë dhe për pasojë koekzistenca paqësore dhe toleranca në barabarësi të plotë janë alternativa e vetme e mundshme. Ekziston edhe alternativa e ndarjes, e cila është mjaft problematike dhe me rrezikshmëri të lartë dhe të gjitha subjektet që kalkulojnë me këtë alternativë, duhet të kenë kujdes që të mos rrëshqasin në ofertën e Georgiveskit të vitit 2001, për pashallëkun e Pollogut me Dibrenë si qytet shtesë për shqiptarët e Maqedonisë.

Maqedonia, si një udhëkryq ballkanik i rëndësishëm, është shumë problem të ripërkufizohet territorialisht, fakt ky që më së miri u verifikua në rastin e Bosnjës. Personalisht jam kundër bosnjëzimit të Maqedonisë, si një fatkeqësi e madhe e të gjithë qytetarëve të saj. Besoj se ideja për Maqedoninë si shtet i dy popujve konstituentë do të realizohet së bashku me procesin e integritetit të vendit në NATO dhe UE, pavarësisht nga fakti që sot duket një ideal i largët dhe i parealizueshëm, duke pasur parasysh kokëfortësinë dhe kundërshtimin e faktorit maqedonas.

PAQJA: Cili do të jetë roli dhe qëndrimi i partisë suaj karshi institucioneve fetare në Maqedoni?

z. Rufi Osmani: Në parim, politika nuk ka pse të përzihet në punët e bashkësive fetare, ashtu siç është edhe obligim i pjesëtarëve të institucioneve fetare të jenë jashtë politikës dhe të mos bëjnë politikë me institucionet fetare. Sot kemi pikërisht një situatë të kundërt, BFI-ja është skajshmërisht e politizuar dhe dy grupimet politike shqiptare qërojnë hesapet me grushte në xhami, që është turp dhe precedent i paparë. Nëse besimtarët kanë zgjedhur xhaminë si vend për të pastruar llogaritë, kjo flet se këta njerëz, pavarësisht nga postet që mbajnë në BFI, mund të jenë çdo gjë, pos besimtarë nuk janë me siguri dhe se dënimi i Zotit do t'i ndëshkojë, nëse jo në këtë botë në ahiret me siguri se po.

Kjo situatë duhet të tejkalohet patjetër. Ekzistojnë dy alternativa të tejkalimit: Në shenjë përgjegjësie për gjendjen ekzistuese në BFI kryesia aktuale të shpallë zgjedhje të parakohshme dhe të mundësojë një konkurrim të ndershëm dhe demokratik, duke ulur moshën dhe duke rritur nivelin akademik të personave që duhet të vijnë në krye të BFI-së dhe alternativa e dytë është grupet reformatore (por jo grupet vehabiste) të marrin iniciativë në kuadër të muftinive për zgjedhje të reja.

Nëse vazhdon status-kuoja, atëherë, ne me keqardhje duhet të konstatojmë se si komb nuk jemi vetëm në krizë të thellë ekonomike, politike dhe sociale, por mbi të gjitha kemi krizë morali dhe besimi, fakt ky që do na kushtojë shumë në perspektivë.

PAQJA: Në rast se do të fitoni, a do të merreni me jetësimin e Marrëveshjes së Ohrit?

z. Rufi Osmani: Marrëveshja e Ohrit tashmë është relikti i të kaluarës dhe ne nuk kemi se pse merremi me të, pjesët e përcaktuara të saj duhet të përfundohen detyrimisht, sepse kjo marrëveshje ka skaduar me 2004. Sfida jonë e radhës është statusi i kombit shtet-formues dhe e tërë energjia jonë duhet të orientohet në këtë drejtim.

PAQJA: Sigurisht se jeni të informuar me faktin se hapi i parë në politikë i njerëzve meritore dhe të mëdhenj përgjatë historisë shqiptare, filloi gradualisht t'i devalvojë, t'i nënçmojë dhe t'i degradojë këta njerëz. A mendoni se një ditë, shumë njerëz që sot juve dhe veprimtarinë tuaj kombëtare dhe profesionale e përkrahin me ngazëllim, mund të shndërrohen nesër në urrejtës të skajshëm ndaj teje dhe veprimtarisë suaj?

z. Rufi Osmani: Një proverb popullor thotë në çdo rregull ka edhe përjashtime. Së pari, kurrë nuk e kam llogaritur veten se bëj pjesë në grupin e njerëzve me merita të veçanta kombëtare. Së dyti, në vijim kam mandatin e tretë politik që ma besoi populli-elektorati dhe ngjashëm si edhe dy mandatet e para (postin e deputetit dhe kryetarit të komunës) do ta menaxhoj me nder, duke i kontribuar maksimalisht realizimit të programit tim zgjedhor, në dobi

të elektoratit në një situatë ku resurset në disponim janë mjaft të kufizuara dhe ku bllokadat e pushtetit dhe të konkurrentëve ndikojnë drejtpërdrejt në uljen e autoritetit dhe besimit të elektorati.

Rreziku i devalvimit që ju përmendni ekziston edhe në rastin tim dhe ai kryesisht u adresohet strukturave kriminale politike dhe ekonomike dhe njerëzve, që nga pozicionet e klaneve nepotike-politike, ndjehen të prekur nga konsistenca politike që unë zbatoj në alokimin me nder dhe me kriteret e mekritokracisë së resurseve publike.

Mbaj shpresë se përkundër faktit që ka njerëz që nuk kanë realizuar pritjet dhe interesat personale dhe që me siguri kanë mëri dhe urrejtje ndaj meje, ato janë grupe marginale në krahasim me një shumicë të njerëzve të rëndomë që çdo ditë më takojnë në komunë, qytet dhe universitet dhe që manifestojnë simpati dhe përkrahje të sinqertë. Puna ime i dedikohet grupit të njerëzve të vullnetit të mirë.



PAQJA: Cili është koncepti i partisë suaj në lidhje me integrimin e shqiptarëve, pra do të bashkohemi si shqiptarë të ndarë e të copëtuar vetëm në BE, apo fillimisht do të bashkohemi në tërësi si komb shqiptar, për të përjetuar kështu një integrim më të arsyeshëm në institucionet ndërkombëtare?

z. Rufi Osmani: Historia na mëson se fatet e kombeve të ndara varen, në një masë të konsiderueshme, nga vullneti i fuqive të mëdha dhe nga rrjedha e proceseve të globalizimit, që në esencë ka fenomenin e integrimit ekonomik, politik dhe të sigurisë.

Analizuar nga ky këndvështrim dialektik, dëshirat tona që së pari të bashkohemi territorialisht si shqiptar bëhen jorelevante, sepse nuk kemi kapacitet që ta realizojmë vetë këtë objektiv madhor.

E kam thënë edhe më herët dhe do e përsëris se fati i kombit tonë ka ngjashmëri të madhe me fatin e kombit gjerman dhe uroj të na përcjellë fati i këtij kombi të madh dhe me vlerë.

Vlerësoj se procesi i integrimit në UE do ketë si rezultat Shqipërinë-shtet amë, Kosovën e pavarur shqiptare dhe Maqedoninë Shqiptare me shqiptarët si komb i dytë shtet-formues në shtetit e përbashkët me maqedonasit. Kjo është alternativa reale e bashkimit të shqiptarëve në Evropën e bashkuar, nëse ky ideal do bëhet realitet dhe nëse në një të ardhme të afërt do të kemi Shtetet e Bashkuara të Evropës.

PAQJA: Krejt në fund, cili është opinioni juaj rreth ofertës dhe kërkesës së madhe për dyshtetësi, duke ia shtuar kësaj që e kemi aktualisht, edhe nën-shtetësinë shqiptare?

z. Rufi Osmani: Në skenën politike dhe intelektuale shqiptare ka shumë paragjykime që janë më tepër sindrom i mentalitetit të vjetër komunist dhe vrojtimit të çështjeve bardhë e zi. Kjo çështje duhet të zgjidhet ashtu siç e kanë zgjedhur shumë kombe më të përparura se ne, duke ua mundësuar të drejtën e dyshtetësisë bashkëkombësve që jetojnë në pjesët e ndara të trungut të përbashkët etnik. Këtë të drejtë e nënkuptoj si një mundësi shtesë për qarkullimin e lirë, me shumë investime të përbashkëta, bashkime familjare dhe kulturore dhe jo si mundësi për shpërngulje nga Maqedonia për në Shqipëri dhe në Kosovë.

Në instancë të fundit, problemi ynë bazë është si të ndërpritet shpërngulja masive dhe integrimi si asimilim vullnetar i emigrantëve ekonomikë shqiptarë në përfundim dhe riatdhesimi i tyre nëpërmjet investimeve të përbashkëta dhe hapjes së vendeve të reja të punës në vendlindje, në një periudhë prej një deri në dy dekada kur procesi i integrimit euro-atlantik i Ballkanit do jetë i përfunduar.

PAQJA: Ju faleminderit që ndatë kohë për këtë intervistë tejet të duhur për opinionin e gjërë.

z. Rufi Osmani: Ju faleminderit për hapësirën që më dhatë, jam i nderuar të jem prezent në faqet e revistës suaj. ■

Mes integritimit dhe ndarjes nga Serbia



Baki REXHEPI

Sipas disa përfaqësuesve politikë dhe institucionalë të shqiptarëve të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës, ndarja nga Serbia dhe bashkimi me Republikën e Kosovës, është vazhdimësi e punës së mundimshme dhe rrjedhojë e një bagazhi politik, siç ishte



Jonuz Musliu

referendumi i mbajtur më 1 e 2 mars të vitit 1992 nën moton “Autonomi territoriale politike me të drejtë bashkëngjitje Kosovës” dhe lufta e armatosur në mes forcave serbo-sllave dhe popullit shqiptar të këtyre trojeve, nën udhëheqjen e Ushtrisë Çlirimtare për Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc.

Disa politikanë të moderuar mendojnë se ekzistojnë ende mjete dhe forma të veprimit, përmes së cilave do të mund të realizohen të drejtat individuale dhe kolektive të shqiptarëve të këtushëm.

Jonuz Musliu- Kryetar i Kuvendit Komunal në Bujanoc

Ish-kryetari i Këshillit Politik të UÇPMB-së, aktualisht kryetar i Kuvendit të Komunës në Bujanoc, Jonuz Musliu, bazuar në idetë e fundit të individëve, analistëve, madje edhe zyrtarëve të ndryshëm, qoftë shqiptarë a serbë, për shkëmbim territore, në mënyrë që të arrihet perspektiva e quajtur sta-

bilitet në rajon, pohoi se “për momentin, shkëmbimi i territoreve, ose ndonjë opSION tjetër i kësaj natyre, për institucionet shqiptare kudo qofshin ato shikohet si një model joreal i zgjidhjes së problemeve shqiptare në planin global. Shqiptarët e Luginës së Preshevës e kanë pasur gjithmonë si synim bashkimin kombëtar, si një opSION të drejtë dhe të qëndrueshëm të zgjidhjes së çështjes kombëtare. Në këtë drejtim edhe u organizua një referendum, u zhvillua një luftë dhe u nxorën disa platforma dhe marrëveshje paqësore. Për të mos i dëmtuar proceset dialoguese të Prishtinës dhe Beogradit, kërkesat e shqiptarëve të Luginës për bashkim, konform vullnetit politik të shprehur me referendum, janë heshtur për motive politike. Tash gjërat kanë filluar të ndryshojnë dhe kutia e “Pandorës” ka filluar të hapet. Shumë opsione kanë filluar të lansohen, por opSIONI më i drejtë, më i qëndrueshëm dhe më pragmatik është ai i cili ka dalë nga

referendumi popullor dhe Marrëveshja Paqësore e Konçulit. Nuk ka opSION më praktik, më real, më human se sa ai i bashkimit të Luginës me Kosovën, pjesë integrale e së cilës ka qenë gjithmonë gjatë historisë. Çdo opSION tjetër do t'i linte gjërat zvarrë, ndaj sa më shpejt të vijjnë proceset integruese, aq më mirë do të realizohen të drejtat e shqiptarëve për integrim dhe bashkim”.



Shaip Kamberi

Shaip Kamberi-Kryetar i Komunës në Bujanoc

Ndryshe udhëheqësi i komunës në Buajnoc, Shaip Kamberi, opSIONin e ndryshimit të kufijve e sheh si një çështje e cila do një analizë edhe nga faktorë të tjerë. “Nisur nga qëndrimet zyrtare të institucioneve në Kosovë e Shqipëri, por edhe nga qëndrimi i njohur i Bashkësisë ndërkombëtare për mosndryshim të kufijve në Ballkan, subjektet shqiptare të Luginës së Preshevës, në Platformën politike të vitit 2006, të rikonfirmuar në deklaratat politike në vitet pasuese, kanë mbajtur qëndrimin për mosndryshimin e kufijve. Interesi madhor shqiptar në Ballkan, në këto momente, është që Kosova të bëhet anëtare e OKB-së, me integritet të plotë territorial, ashtu siç është shprehur në Deklaratën e Pavarësisë. Në këtë kontekst, interes i shqiptarëve të Luginës së Preshevës është që të kërkojnë tretman të njëjtë me pakicën serbe në Kosovë, respektivisht, në parimin e reciprocitetit. Ekzistimi i pakicave të privileguara në Ballkan mund të jetë një burim i vazhdueshëm i ruajtjes së krizave, prandaj, njëjtësimi i të drejtave të pakicave mund të jetë një zgjidhje që sjell stabilitet”, - theksoi kryetari i komunës së Bujanocit Shaip Kamberi.

Belgzim Kamberi- Kryetar i KDNJ-së në Luginë

Belgzim Kamberi, kryetar i Këshillit



Belgzim Kamberi

të Drejtave të Njeriut në Luginë, mendon se në rrethanat e tanishme, Bashkimi i Luginës së Preshevës me Kosovën është gjithsesi interes i shqiptarëve të Luginës së Preshevës, sepse sipas tij “Serbia deri më tani nuk ka arritur t’iu ofrojë shqiptarëve zhvillim shoqëror. Përkundrazi, ajo është sjellë sikurse shqiptarët të ishin qytetarë të huaj dhe, si reagim, vullneti për bashkimin me Kosovën është jo vetëm legjitim, por edhe i arsyeshëm”.

I njëj mendje është edhe zëvendëskryetari i Kuvendit Komunal të Preshevës, Orhan Rexhepi. Ai nuk e sheh faktor

relevant vendimmarrës Luginën e Preshevës, për ndërrim të territoreve, por sipas tij “a do të bashkohemi a jo me Republikën e Kosovës, më së shumti, do të varet pikërisht nga ne. Po të mos i konvenojë shqiptarëve të Luginës së Preshevës ribashkimi me Kosovën, ata nuk do të kishin bërë një referendum nga i cili 99,7% u deklaruan për këtë ribashkim, po them ribashkim sepse Presheva dhe Bujanoci kanë qenë pjesë administrative e Kosovës deri në vitin 1956, atëherë kur edhe u ndërruan me Leposaviqin dhe Zubin Potokun. Fundja, pushkët nuk u kapën kot së koti dhe rezultati i po këtij referendumi dhe po kësaj lufte të armatosur duhet patjetër të finalizohen. Më e rëndësishmja është se ky ribashkim nuk na konvenon vetëm neve shqiptarëve në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, por edhe atyre që më në fund kanë vendosur të përmirësojnë gabimet e mëdha historike, të cilat u bënë në vitin 1878 në Kongresin e Berlinit dhe sidomos në vitin 1913 në Konferencën e Londrës në dëm të tokave shqiptare. Këtë thujse drejtpërdrejt e paralajmëroi në 10 Qershor 2007 në Tiranë kryetari amerikan Xhorxh Bush



kur në mënyrë decisive tha se duhet të ndërpritet boshti Beograd-Athinë, unë po them Korridorin Dhjetë dhe të krijohet trekëndëshi Tiranë-Athinë-Beograd dhe atëherë drejtësia aq e aq shumë e pritur do të fitojë, sepse përfundimisht do të jemi hiç më pak se dhjetë milionë në një shtet”, - theksoi Rexhepi.



Orhan Rexhepi

Orhan Rexhepi-Zëvendës Kryetar i Kuvendit Komunal në Preshevë

Rexhepi mendon se çështja e bashkimit të Luginës me Kosovën, është “opsion që do të realizohet patjetër në



praktikë, sepse në bazë të asaj që thashë më parë nuk ka alternativë tjetër, sepse të gjitha alternativat e mundshme janë provuar dhe janë harxhuar, sepse padrejtësive të mëdha në kurriz të popullit dhe tokave shqiptare u ka ardhur fundi, por natyrisht duhet një këmbëngulje e madhe e spektrit politik shqiptar në Luginë, pse jo edhe e atij në Kosovë dhe atij në Shqipëri”.

Ndërkohë që Jonuz Musliu, këtë çështje e sheh fare lehtë që të realizohet. “Mjafton një konsensus mes Prishtinës dhe Beogradit. Problem janë serbët e veriut të Kosovës, të cilët çështjen e tyre e kanë aktualizuar pas luftës, ndërsa shqiptarët e Luginës kanë qenë aktivë në të gjitha proceset për t’i realizuar aspiratat e tyre shekullore për bashkim kombëtar”.

Realizimi i shkëmbimit të territoreve, sipas Belgzim Kamberit, derisa nuk ka marrëdhënie të normalizuara midis Serbisë dhe Kosovës në veçanti, dhe shqiptarëve dhe serbëve në përgjithësi, mbetet si opsion gjithsesi i hapur”.

Nga ana tjetër, publikimin e planeve serbe për strategjitë e tyre në raport me Kosovën, politikanët shqiptarë të Luginës nuk i marrin shumë serioze. Në këtë plan, kryetari i komunës më veriore të etnikumit shqiptar, Shaip Kamberi, lidhur me planin e presidentit serb Tadiq, ka thënë, “në periudhën e pasluftës në Kosovë, Serbia ka hartuar plane publike dhe sekrete, plane aksionare, detajet e të cilit nuk kanë qenë të njohura as për parlamentin serb, prandaj ekzistimi i ndonjë plani të ri nuk paraqet kurrfarë risi. Ajo që paraqet realitetin, të cilin serbët detyrimisht do ta njohin, pas situatës së krijuar me mendimin e GJND-së, është se Kosova është e pavarur, se ajo duhet të ushtrojë pushtetin në tërë territorin e vet dhe se ajo duhet të anëtarësohet në OKB. Realizimi i këtyre objektivave, detyrimisht, do të ndihmojë shqiptarët e Luginës së Preshevës në bisedat teknike mes Kosovës e Serbisë.”

I pyetur se sa po punon spektri politik shqiptar i Luginës në drejtim të përfshirjes së mundshme në ndonjë proces negociatash, qoftë ky edhe ai i negociatave për çështje teknike, apo edhe për bashkim me Kosovën, njeriu i parë i ekzekutivit në Bujanoc, Shaip Kamberi, është përgjigjur: “Ne respektojmë qëndrimin e institucioneve të Kosovës dhe Shqipërisë, duke e parë synimin e tyre si aspiratë të gjithë shqiptarëve për arritjen e njohjeve të mjaftueshme që Kosovën



do ta fusin në OKB dhe me këtë t’i krijojnë subjektivitet të plotë ndërkombëtar. Ne besojmë se në tërë këtë angazhim, institucionet e Kosovës dhe Shqipërisë do të kenë parasysh interesat e shqiptarëve të Luginës së Preshevës, si tërësi e jo komunat ndaras. Të gjithë duhet të jenë të vetëdijshëm se pa shqiptarët e Bujanocit, kufiri i Kosovës nuk është te “Çeshmja e Eminit”, por në Gjilan, prandaj e konsiderojmë si obligim madhor edhe tonin, por edhe të faktorit politik mbarëkombëtar që Lugina e Preshevës të ndihmohet për ta ruajtur substancën kombëtare, së pari, e mandej edhe për zhvillim ekonomik e kulturor, që do të mundësojë realizimin e këtij objekti.”

Ndryshe nga kryetari Kamberi, mosangazhimin e klasës politike të Luginës, për veprime që shpesh përmenden nga të tjerët si opsione të mundshme për një zgjidhje të gjendjes në rajon, Belgzim Kamberi, thotë se “kjo klasë nuk ka aktualisht kapacitete dhe fuqi të duhur politike për të jetësuar këtë synim të tyre politik. Skena politike është thellësisht e përçarë politikisht dhe e orientuar kryesisht në politikën lokale. Thjesht, ajo nuk bën politikë, por më shumë merret me administrim. Kështu që ka më shumë gjasa që të përsëritet sërish skenari i bisedimeve të Vjenës, ku jo vetëm përfaqësuesit politikë shqiptarë të Luginës së Preshevës nuk ishin pjesë të procesit, por as vetë Lugina e Preshevës.”

Mendimet pro et contra opsioneve, të cilat tashmë kanë zënë vend në politikën ditore, nxjerrin në pah edhe gjendjen e skenës politike shqiptare në tri komunat e Luginës së Preshevës. Kjo situatë është edhe më reale dhe më e natyrshme te masa e gjerë. Ndryshimet kanë vënë dilemën se “shqiptarët e Luginës së Preshevës gjenden mes integritimit apo mes ndarjes nga Serbia”. ■

LUFTA PËR PREFEKTURAT

Muaviu, pasi i provoi forcat dhe nuk arriti të pushtonte Gadishullin Arabik, i kërkoi Aliut r.a. armëpushim. U këmbyen shumë letra dhe, më në fund, Muaviu kërkoi nga Aliu r.a. që mos të ndërmerre aksione ushtarake kundër tij në Sham dhe përreth tij, gjithashtu edhe ai nuk do të ndërhynte në punët e tij në Irak dhe rrethinat e tij.

Muhamed J. KAJOLLI

Takimi i shumëpritur në Deumetul Xhendel jo që nuk arriti ta bashkonte umetin, por, u bë shkaktar i shumë betejave të tjera. Nga ky takim nuk u ndanë të kënaqur as kalifi, Aliu r.a., e as Muaviu, edhe pse këtij të fundit i shkoi për shtat. Pas këtij takimi, pushteti i Aliut r.a. u shpërbë gjithnjë e më tepër, ndërsa ai i Muaviut u fuqizua çdo ditë e më shumë. Kur Muaviu e kuptoi se kalifi i muslimanëve po e humbiste forcën drejtuese, atëherë e shpalli veten kalif të Shamit dhe menjëherë filloi t'i dërgonte ushtarët e tij për të shtrirë ndikimin e tij në prefekturat në të cilat nuk kishte pushtet.

Anomalia dhe hutimi i muslimanëve

Banorët e shtetit musliman u hutuan plotësisht pas mospërcaktimit të gjykimit që u mbajt në Deumetul Xhendel. Këtë e vërtetoi edhe letra e Aliut r.a. drejtuar banorëve të Irakut, nga e cila mësuam se kalifi ishte i zemëruar shumë nga ngjarjet e zhvilluara. Ushtria e tij tregoi se ishte e stërlodhur, jo nga barra fizike, por nga ngarkesa psikike e shumë vrasjeve të të afërmeve. S'do mend se depresioni psikik luajti rolin vendimtar kundër ushtrisë së kalifit, mirëpo kjo nuk do të thotë se ushtria e Aliut r.a. dyshonte në drejtësinë dhe në përpjekjet e tij për ta stabilizuar vendin, në të cilën kishte marrë hov anomalia, ose ndryshe thënë anarkia e plotë. Në anën tjetër, motivi për ta luftuar më tutje ushtrinë e kalifit të vetëshpallur u dobësua edhe më shumë.

Prandaj në shtetin islam në përgjithësi e në veçanti te banorët e Irakut mbretëroi një hutim i plotë. Për këtë situatë dëshpëruese kishte paralajmëruar Muhamedi s.a.v.s. në një thënie të tij, i cili për trazirat që do të ndodhnin kishte thënë: "Pas meje do të ndodhin trazira, do të vdesin zemrat e njerëzve ashtu siç vdes trupi i njeriut. Do të gdhijnë besimtarë, ndërsa do të ngrysen mosbesimtarë" (Dinuri 1/147)

Mendoj se do të mjaftonte të paraqes një prej anomalive të regjistruara, prej shumë sosh, në historinë islame. Taberiu na tregon se në çfarë gjendje kishte rënë shteti në atë kohë dhe cila ishte gjendja e qytetarëve të tij. Ai ka regjistruar letrën e një qytetari, i cili kërkonte ndihmë nga kalifi: "E informova kalifin e muslimanëve për kalimin e ca kalorësve përreth Kufës, të cilët ishin drejtuar nga Niferi, ndërsa unë jam prej rrethit të Dihakinës. Derisa po qëndroja poshtë lumit Euftrat pashë Zadhan Ferruhin, i cili po falej nga ana tjetër e lumit. Më vonë erdhën ca kalorës, të cilët e pyetën: 'A je musliman apo kafir?' Ai u përgjigj se ishte musliman. 'Ç'mendim ke për Aliun?', - e pyetën. 'Është prej më të mirëve, është emiri i besimtarëve dhe zotni i njerëzimit', - iu përgjigj ai. Të zemëruar i thanë: 'Bëre herezi-kufir or armik i Zotit. Rebelët e morën zvarrë dhe e copëtuan trupin e tij. Më pas kishin takuar një njeri tjetër, ai nuk paska qenë musliman dhe nuk i paskan bërë asgjë. Më pas ne e takuam jomuslimanin dhe na tregoi për atë ç'kishte parë dhe çfarë e kishin pyetur. Jemi munduar të mësojmë më shumë për atë grup rebelësh, por nuk arritëm të marrim asnjë të dhënë për ta. Kemi dëshirë që emiri i besimtarëve të na japë mendimin e tij rreth kësaj ngjarje dhe selam.'" (Taberi: 5/78)

Urdhri për marshim të ri refuzohet

Aliu r.a. pasi pastroi rebelët havarixh u kthye në Kufe. Meqë e kishte të pazgjidhur problemin me Muaviun, ai kërkoi prej ushtrisë së tij të marshonte drejt Shamit. Mirëpo gjendja në Kufë nuk ishte sikurse që e kishte lënë para se të shkonte në betejën e Nahravanit. Shumica dërmuese e rebelëve të vrarë nga ushtria e kalifit ishin nga Kufja dhe kjo do të thoshte se secili i vrarë kishte anëtarë të familjes së tyre në ushtrinë e kalifit. Kur ushtarët u

kthyen në shtëpitë e tyre për t'u pajisur me armatim të ri dhe për t'u bërë gati për të marshuar drejt Shamit, ata nuk u pritën mirë nga pjesëtarët e familjeve të tyre. Qytetarët nuk e dinin saktë se ç'po ndodhte dhe kush ishin havarixhët, prandaj gjykimet e tyre nuk ishin të njëjta me atyre të ushtarëve të kalifit. Të prekur nga veprimet e tyre, shumica nuk do të ishin më në gjendje ta ndihmonin kalifin për të luftuar në Sham, gjegjësisht Muaviun.

Ata jo që nuk dolën në thirrjen e mobilizimit të ri, por në ndërkohë brenda qytetit të Kufës u shfaqën disa të rinj të zemëruar e të penduar që kishin marrë pjesë në ushtrinë e kalifit, për shkak se kishin vrarë pjesëtarët e familjeve të tyre. Këta të zemëruar do t'i bashkëngjiteshin mbetjeve të havarixhëve të tjerë dhe kështu sërish u bë një grup havarixhësh të rinj. Thuhet se ky grup nuk kalonte treqind vetë dhe se për komandant të tyre kishin zgjedhur Sirin Ibën Rashid En Naxhin.

Dikush mendon se edhe sot e kësaj



dite ka havarixhë, të cilët nuk e kanë ndërprerë asnjëherë rigrupimin e tyre. Personalisht mendoj se grupe të këtij karakteri kundër muslimanëve nuk ka, por vetë dijetarët janë ata që e rikujtojnë ideologjinë e tyre nëpër debatet rreth lëndës së akaidit. Ndërsa grupe të reja kundër muslimanëve ka pasur dhe gjithmonë do të ketë në të gjitha shoqëritë njerëzore, por këtu nuk kemi të bëjmë me vertikalen e hierarkisë së havarixhëve të vjetër, por kemi të bëjmë me njerëz që rebelohen brenda një grupi politik ose fetar dhe formojnë grupimin e tyre. Prej tyre kemi që ndahen në vetvete dhe nuk paraqesin rrezik, por, ka edhe prej tyre që merren me terrorizëm, si rezultat i filozofisë për të bukurën dhe për të shëmtuarën. Këta të fundit mund të veprojnë sikur havarixhët, por në esencë nuk kanë të bëjnë fare me organizimin hierarkik të havarixhëve të vjetër ose me zinxhirin komandues të tyre që nga koha e Aliut r.a..

Lindja e kalifit të ri dhe vrasja e Muhamed Ebi Bekrit

Deri në vitin 38 h., shteti islam kishte vetëm një kalif të shpallur. Mirëpo, kur prefekti i Shamit (Muaviu) e pa se në lindje të shtetit të tij trazirat nuk kishin të ndalur dhe kur mësoi se Aliu r.a. nuk arriti të grumbullonte forca të reja kundër tij, ai kërkoi nga elita e Shamit që të propozohej për kalif. Meqë njerëzit

ishin të lodhur nga vëllavrasjet dhe trazirat që nuk u shihej fundi, edhe pse nuk e kishin Muaviun të preferuarin e tyre për kalif, populli do ta pranonte ofertën e elitës së Shamit dhe do t'ia jepte betimin Muaviut, birit të Sufjanit. Që prej atij momenti mund të thuhet se shteti i muslimanëve do të udhëhiqej nga dy kalifë.

I emëruar në këtë post, Muaviu i duhej të tregonte forcën e tij në praktikë se e 'meritonte' atë. Ai do t'ia jepte urdhër Amër Ibën As-it që të përgatiste një ushtri prej gjashtëmijë vetash për t'ia mësyre Egjiptit. Gjeografikisht, Egjipti ishte më afër Shamit dhe duke u bazuar në ndihmën e brendshme të përkrahësve të Osmanit r.a., ai mendonte se do ta shtrinte ndikim e tij në Afrikën Veriore. Platforma e paraqitur prej tij ishte e logjikshme dhe ashtu ndodhi.

Mendohet se ushtrisë së Amër Ibën As-it iu bashkëngjitën rreth dhjetë mijë të tjerë nga Egjipti. Kur Muhamed Ebi Bekri u informua për nisjen e Amr-it nga Shami, ai i shkroi letër kalifit Aliu r.a. në të cilën i tregon për gjendjen në Egjipt dhe pamundësinë e tij për t'u përballur me ushtrinë e Amrit, nëse atij nuk do t'i shkonin ndihma ushtarake dhe para. Aliu r.a. iu përgjigj atij pozitivisht, por faktori kohë bëri që ndihma të mos i arrinte në momentin e duhur.

Ushtria e Amr-it veç i ishte afruar dyerve të Fustatit-Kajros dhe ai i shkroi letër Muhamedit, në të cilën e këshilloi të dorëzohej pa derdhur gjak. Mirëpo Muhamedi i bindur se ndihma do t'i arrinte në kohë, e refuzoi ofertën e Amrit. Ai, për të fituar kohë nxori dy mijë ushtarët e tij për të luftuar me në krye Kunane Ibën Bishr, mirëpo ndihma nuk arriti dhe ushtria e Kunanes pësoi disfatë. Muhamedi u detyrua të ikte nga Fustati-Kajroja në drejtim të panjohur. (Bidaje: 5/546-7)

Pasi mbaroi punë me ushtrinë e Kunane Ibën Bishr-it, ushtria e Amr Ibën As-it hyri si ngadhënjimtare në Kajro në Rebiul Evel 38/ 29 gusht 658-të, ndërsa Muavije Ibën Hudejxh u vu pas gjurmëve të Muhamedit Ibën Ebi Bekrit. Pas disa ditë kërkimesh, edhe Muhamedi u kap dhe u vra menjëherë nga Ibën Hudejxhi. Bazuar në përshkrimin e gjeneralit Mukhtar Pasha

dhe Ibni Kethirit, ai jo vetëm që e vrau, por ia preu kokën dhe ia dërgoi Muavi Ibën Sufjanit në Damask. Kjo është koka e parë e prerë ndër myslimanë, ndërsa pjesën tjetër të kufomës e bashkoi me mbeturinat e gomarit dhe e dogji. (Mukhtar Pasha:70, Bidaje: 5/547)

Po në këtë vit, Muaviu e dërgoi në Basra Abdullah Ibën Hadremium me detyrë për të destabilizuar vendin. Ai synonte që ta përgatiste popullin në kryengritje kundër Aliut r.a., mirëpo dështoi. Itharët e Aliut r.a. ishin më të shumtë dhe e kuptuan komplotin e kurdisur prej tij dhe arritën ta vrasin...

Lufta për shtrirjen e pushtetit vazhdonte

Muavi Ibën Sufjani i entuziazmuar me fitoren e Egjiptit, do të vazhdonte të dërgojë ushtarët e tij në disa fronte, ndërsa komandantëve të tij u kishte dhënë instruksione që të vrisnin secilin që qëndronte përkrah Aliut r.a., pa marrë parasysh nëse ata ishin civilë ose të armatosur, mjaftonte që ata të deklaroheshin se e njihnin Aliun r.a. për kalif. Në vitin 39-të, Aliu r.a. vazhdoi të ishte i preokupuar me mbetjet e havarixhëve dhe persët. Si rezultat i këtij preokupimi, Aliu r.a. do t'i humbisnin edhe disa teritore të tjera, të cilat do të arrinte t'i rifitonte një vit më pas.

Sulmet në Irak

Bazuar në të dhënat e historianit Taberij, të përshkruara nën titullin: Ngjarjet më të rëndësishme të vitit tridhjetë e nëntë hixhri, thuhet se të gjitha sulmet ushtarake që u ndërmorën nga ushtria e Muaviut në Irak dështuan edhe pse Aliu r.a. ishte dobësuar shumë ushtarakisht.

Ushtria e Muaviut dështoi në Ajnu Temër, ku ai kishte caktuar komandant Nuëman Beshirin në krye të njëmijë ushtarëve, kështu pësoi disfatë edhe komandanti Sufjan Ibën Aufi në krye të gjashtë mijë luftëtarëve në Embar. Dështoi edhe në Tejma, edhe pse kishte caktuar Abdullah Ibën Mesa'ade El Fizarijin në krye të njëmijë e shtatëqind ushtarëve. Aliu r.a. dërgoi përballë kësaj ushtrie Musejeb Bin Nexhbe El Fizarijin dhe e mposhti.

Ndërsa sulmet e Dahak Ibën Kajsit, i cili ishte në krye të tre mijë ushtarëve ishin më të veçanta. Ky komandat ishte caktuar të plaçkiste pasuritë e qytetarëve të Irakut dhe të vriste secilin që e njihje Aliun për kalif. Kundër këtij koman-





danti Aliu r.a. kishte caktuar Huxhr Bin Adij El Kindijin, në krye të katër mijë ushtarëve, i cili e shpartalloi ushtrinë e Dahakut, i cili vetë shpëtoi pasi arriti t'ia mbathte për në Sham.

Sulmet në Hixhaz (Gadishulli Arabik)

Ishin muajt e haxhit. Bazuar në El Vakidij,¹ Aliu r.a. caktoi Ubejdullah Ibën Abasin për të udhëhequr haxhinjtë. Ai do ta këshillonte atë duke i thënë: “Shpjegohu njerëzve kryerjen e haxhit dhe përkujtoja ditët e Zotit. Organizoj tubime në mëngjes dhe në mbrëmje për t'i dëgjuar problemet e tyre. Sqaroi ata që të pyesin, mësoje të paditurin dhe diskuto me të diturit. Midis teje dhe njerëzve të mos ketë ndërmjetësues tjetër pos gjuhës tënde, as paravan pos fytyrës tënde. Mos pengoj askënd, i cili dëshiron të takohet me ty, kur ai të ka ardhur në derën tënde, sepse as përm-bushja e pastajme e kërkesës së tij nuk do të sjellë mirënjohje. Shiko ç'ke grumbulluar nga pasuria e Allahut dhe ndaj atyre që janë përreth teje, që kanë fëmijë dhe që kanë halle, prej të uriturve dhe të zhveshurve, ndërsa ajo që do të teprojë na e dërgo neve këtu që t'ua ndajmë ne.” (Shtegu i elokuençës: 292)

Meqenëse edhe Muaviu tani ishte kalif, edhe ai do të caktonte udhëheqësin e tij të haxhit-Jezid Ibën Shexheren. Njerëzit e Mekës, si dhe haxhinjtë, u hutuan akoma më shumë. Ata nuk dinin kujt t'i drejtoheshin dhe me cilin të merreshin më shumë, prandaj vetë

1 Tarih Taberi, 5/92 (ndërsa Ibni Kethir thotë se ishte Kutham Ibën Abas)

sahabët do të caktonin prijësin e tyre gjatë kohës së haxhit. Kështu, hëpërhë, këtë vit problemi do të zgjidhej me Shejbe Ibën Osman Ibën Ebi Talha, si udhëheqës i haxhit. Për të mos e prishur rehatinë e haxhit, dy përfaqësuesit e të dy kalifëve do të heshtnin.

Pas mbarimit të haxhit, numri i ushtarëve të Jezidit ishte shumë më i madh se sa ai i përfaqësuesit të Aliut r.a., prandaj ai e shpalli Mekën si zonë të kalifatit të Muaviut. Aliu r.a., për shkak të preokupimit të tij me persët e rebeluar, nuk do të arrinte t'i dërgonte Ubejdes ushtarë shtesë.

Pastaj, në vitin 40 hixhri ose 660 gregorian, Muaviu kur e pa se Aliu r.a. nuk kishte forca për të dërguar në Gadishullin Arabik, dërgoi një ushtri tjetër prej tre mijë ushtarësh me në krye Busre Bin Ebi Ertatin për në Hixhaz. Busre hyri në Medinë pa kurrfarë rezistence, prefekt i së cilës ishte Ejub El Ensariu. Ai iku dhe shkoi tek Aliu r.a. në Kufe. Me të hyrë në Medinë hipi në minber dhe tha: “...Nuk do të keni paqe nga unë derisa nuk do të ma dorëzoni Xhabir Bin Abdullahun...” Xhabiri shkoi dhe u këshillua me gruan e Pejgamberit s.a.v.s. Um Seleme, ndërsa ajo i tha që t'ia jepte besën...”

Pastaj mori rrugën për në Mekë. Ebu Musa u frikësua shumë se mos po e vriste, por ai ia ktheu se nuk kishte ndërmend ta bënte atë, sepse ishte sahabij. Ndërsa Ebu Musa i shkroi letër Ubejdullah Ibën Abasit, i cili tanimë kishte shkuar në Jemen. Ushtarët e Muaviut vrisnin secilin që u dilte përpara dhe të gjithë ata që kundërshtonin. Ubejdul-

lahu u largua nga Jemeni dhe shkoi tek Aliu r.a. në Kufe, ndërsa për zëvendës e la Abdullah Ibën Abdul Medan El Harithijin. Me të arritur atje, Busre e vrau atë dhe dy fëmijët e Ubejdullah Ibën Abasit.

Derisa Busre ishte në Jemen, Aliu r.a. e stabilizoi gjendjen e tij me havarixhët dhe me persët e rebeluar, të cilët u pajtuan. Persët përfundimisht iu rikthyen ombrellës së shtetit islam, ndërsa Aliu i dërgoi dy mijë ushtarë me në krye Xharije Ibën Kudamen dhe dy mijë të tjerë me në krye Vehb Ibën Mesudin kundër Busres. Me të dëgjuar Busre për këtë dërgesë, ia mbathi, por ushtria e tij u takua me ushtrinë e Xharjes në Nexhran. Busre pësoi disfatë, por arriti të ikte dhe të kthehej në Sham. Komandati i Aliut r.a. shkoi në Mekë dhe në Medinë dhe kërkoi nga populli që të vazhdonin ta njihnin Aliun për kalif të tyre dhe kështu ai i riktheu vendet që ishin nën pushtetin e Aliut r.a....(Tarikh el Taberij: 5/94)

Armëpushimi

Pasi Muaviu provoi forcat dhe nuk arriti ta pushtonte Gadishullin Arabik, kërkoi nga Aliu r.a. armëpushim. U këmbyen shumë letra dhe, më në fund, Muaviu kërkoi nga Alia r.a. që të mos ndërmerre aksione ushtarake kundër tij në Sham dhe përreth tij, gjithashtu edhe ai nuk do të ndërhynte në punët e tij në Irak dhe rrethinat e tij. Pas më shumë se katër vjet fitoi arsyeja dhe Aliu r.a. pranoi të ndërpriten luftimet. (Tarikh el Taberij: 5/95)

Në numrin e ardhshëm – Atentatet dhe vdekja e Aliut r.a.

Ramazani - Muaji i mëshirës dhe i bujarisë

“U erdhi ky muaj, që ka vlerë më shumë se njëmijë muaj, e atij që i ndalohe, i është ndaluar gjithë mirësia. Të mirën e tij e refuzon vetëm i mallkuari”.

(Hadith, Ibën Maxhe).

Ajni SINANI

Cdo gjë vjen në ekzistencë në një çast të caktuar dhe pas një periudhe të shkurtër ose të gjatë kohore zhbëhet dhe shuhet. Kalojnë ditë, vite dhe njerëzit largohen prej kësaj bote. Që të gjithë këta, një ditë do të paraqiten para Sundimtarit të Ditës së Gjykimit (Malik jevmi din), prandaj njeriu e ka për obligim që të mendojë për këtë, sepse e mira dhe e keqja do të shihen qofshin sa grima (El Zelzele: 7-8).

Njeriu i sotëm ndien boshllëk shpirtëror si pasojë e largimit të tij nga Krijuesi, prandaj ai duhet t’iu kthehet vlerave shpirtërore dhe Ramazani është një rast i volitshëm në këtë drejtim. Kush i gëzohet Ramazanit dhe ia hap zemrën e shpirtin atij, Allahu e derdh me bollëk mbi të mëshirën e Tij.

Ramazani është një pranverë për shpirtin e besimtarit, që ia mbush atij zemrën me mëshirë, dhembshuri, delirësi dhe dashuri. Pejgamberi a.s. thotë: “Umetit Tim i janë dhënë pesë gjëra në Ramazan që nuk janë dhënë asnjë umeti më parë:


1. Era e gojës së agjëruesit, gjersa ai agjëron, është më e dashur për Allahun se aroma e mis-kut.
2. Melekët luten për faljen e mëkateve të agjëruesve derisa ata të përfundojnë agjërimin.
3. Allahu e zbukuron çdo ditë xhenetin për ta dhe thotë: edhe pak dhe do të largohet çdo brengë dhe shqetësim prej robërve të Mi dhe ata do të vinë te ti.
4. Pengohen të gjitha intrigat e shejtanit dhe ata nuk mund të bëjnë atë që bënin më parë;
5. Atyre u falen mëkatet natën e fundit. Dikush pyeti: Mos është në natën e Kadrit, o Pejgamber i Allahut? I Dërguari i Allahut u përgjigj: Jo nuk është, por kur një punëtor kryen punën e vet, në fund i jepet edhe pagesa për atë punë.” (Imam Ahmedi).

Namazi i natës që shpërblehet më së shumti është ai që falet gjatë Ramazanit. Pejgamberi a.s. ka thënë: “Kush e kalon muajin e Ramazanit duke u falur gjatë natës, duke besuar dhe shpresuar vetëm tek Allahu, do t’i falen mëkatet e mëhershme”.

Agjëruesi i vërtetë është ai që jeton me librin e Allahut, sepse Ramazani është muaji në të cilin

"O ju që besuat,
agjërimi v është bërë obligim
sikurse që ishte obligim edhe i atyre
që ishin para jush,
kështu që të bëheni të devotshëm."

Kur'an, 2: 183.



ka filluar zbritja e Kuranit, i cili është shërim i sëmundjeve dhe zgjidhje e halleve dhe problemeve tona, sepse Kurani është mëshirë dhe shërim. (El Isra: 82).

Pejgamberi a.s. ka thënë: “Më i miri mes jush është ai që e lexon Kuranin dhe ua mëson atë të tjerëve.” (Buhariu).

Gjatë këtij muaji duhet të pendohemi dhe të zotohemi se nuk do t’ju kthehemi më mëkateve të mëhershme.

Duhet t’i shtojmë lutjet dhe duatë tona. Dijetari i madh Ebu Hamid El Gazaliu e krahason duanë me mburojë që mbron nga shigjetat dhe heshtat, sepse lutja e mbron besimtarin nga fatkeqësitë dhe sprovat. Por ai nuk duhet të nxitohet në pranimin e duasë së tij nga ana e Krijuesit. Pejgamberi a.s. ka thënë: “Allahu i përgjigjet lutjes së robit të Tij, nëse robi nuk nxiton të thotë: jam lutur, por nuk më është plotësuar lutja!”. (Buhariu, Muslimi etj).

Islami dëshiron të ndërtojë një njeri që sakrifikon të mirat materiale dhe jetën e tij për të mirën e shoqërisë.

Agjërimi dhe namazi zhvillojnë vlerat e brendshme të zemrës dhe shpirtit dhe ndikojnë në formimin e karakterit fisnik tek agjëruesi. Në Ramazan është e obligueshme dhënia e sadakatul fitrit, si dhe rekomandohet dhe është e pëlqyeshme dhënia e zekatit të obligueshëm dhe e sadakave të ndryshme për njerëzit e varfër dhe skamnorë.

Në një hadith thuhet: “Pejgamberi i Allahut e ka përcaktuar sadakatul fitrin si pastrim për agjëruesin nga fjalët e turpshme dhe bisedat e kota dhe si furnizim për të varfrit. Prandaj kush e jep atë para namazit të Bajramit i llogaritet si sadakatul fitër, e nëse e jep pas namazit i llogaritet si sa-

daka (e rëndomtë).” (Ebu Davudi, Ibn Maxhe dhe Hakimi).

Nga urtësitë e agjërimin është që i pasuri të ndiejë urinë me të varfrin dhe të kuptojë vlerën e mirësive dhe pasurisë. Muhamedit a.s.: “Nuk është musliman i vërtetë ai që ka barkun plot, kurse fqinji përkrah tij është i uritur.”

Shoqëria që nuk i respekton këto vlera digjet në flakën e ndasive të saj klasore si rezultat i korrupsionit, padrejtësisë dhe amoralitetit.

Agjëruesi nuk duhet të përgojë, të mashtrijë, të gënjejë, sepse veshi, syri, gjuha, mendja dhe zemra e tij duhet të agjërojnë nga çdo gjë që shkakton zemërimin e Allahut. Agjëruesi duhet të jetë i përmbajtur dhe të mos flasë fjalë të papëlqyeshme, të mos bëjë vepra të ndaluara dhe të tregojë respekt ndaj agjërimin të tij. Dhe nëse ndodh që dikush ta ofendojë atë, ai nuk i përgjigjet atij në të njëjtën mënyrë. Pejgamberi a.s. ka thënë: “Agjërimi mbron nga morali i keq, sepse ai që agjëron nuk flet gjëra të turpshme dhe nuk bërtet. Nëse e shan dikush ose e sulmon, lë të thotë: “Unë agjëroj, unë agjëroj!”” (Buhari dhe Muslimi).

Aisha r.a. tregon: “Kur hynin dhjetë ditët e fundit të Ramazanit, Pejgamberi i Allahut e shtrëngonte rripin, falej gjatë natës dhe zgjonte familjen e tij për namazin e natës.” Nga kjo që thotë nëna e besimtarëve, kuptojmë se i Dërguari i Allahut i kalonte netët në namaz duke lexuar Kuranin, duke kërkuar falje dhe duke përmendur Allahun në kërkim të natës së Kadrit.

Një prej veprave shumë të lavdërueshme tek Allahu është edhe përkujdesja ndaj jetimëve. Në hadithin që transmeton Buhari, Muhamedi a.s. ka thënë: “Unë dhe ai që kujdeset për jetimin do të qëndrojmë në xhenet si këta dy gishtat! (duke bashkuar gishtin tregues dhe të mesëm me njëri-tjetrin).

Preferohet gjithashtu të vizitohet të afërmit, të sëmurët, të ushqejmë skamnorët, të bëjmë iftar me të tjerët, të kërkojmë falje nga ata që iu kemi bërë padrejtësi, të pajtohemi me ata që nuk flasim, t’i pajtojmë njerëzit e hidhëruar dhe të marrim pjesë në përcjelljen e ndonjë xhenazeje.

Agjërimi është mëshirë e Allahut që ia ka dhuruar robërve të Vet, duke i udhëzuar ata në atë që është e dobishme për trupin dhe shëndetin e tyre, në mënyrë që të arrijnë jetë të lumtur dhe të denjë në këtë botë dhe shpërblimin në botën tjetër.

Pejgamberi a.s. ka thënë: “Çdo punë e njeriut i përket atij dhe për atë vepër do të shpërblehet dyfish, madje deri shtatëqind herë. Allahu i madhëruar thotë: ‘Pos agjërimin. Ai është i Imi dhe Unë shpërbëj për të, sepse agjëruesi për Mua ka braktisur kënaqësitë dhe ushqimin’. Agjëruesi ka dy gëzime, kur bën iftar dhe kur do të takojë Allahun, dhe kjo do të ndodhë në botën tjetër, kur njeriu do të dëgjojë thirrjen: Ku janë agjëruesit? Le të hyjnë në xhenet përmes derës Rejhan, përmes së cilës nuk mund të hyjë askush tjetër përveç tyre.” (Buhariu dhe Muslimi). ■

BOTA ËSHTË MBËRTHYER NË FATKEQËSI

Agim AVDIU

Ditëve të fundit fatkeqësitë kanë pllakosur pjesë të ndryshme të botës. Bëhet fjalë për një çrregullim të theksuar klimaterik, që përshkohet me situata alarmante, të cilat godasin drejtpërsëdrejti edhe popullatën civile, duke shkaktuar katastrofa të shumta humanitare me përmasa të pallogaritshme.



Zjarret në Rusi

Rusinë e ka përfshi një thatësi e madhe që nuk mbahet mend në 130 vitet e fundit. Qindra zjarre kanë rrethuar edhe Moskën, kurse në përpjekje për shuarjen e tyre gjejnë vdekjen edhe zjarrfikësit. Ka kaluar mbi 50 numri i viktimave, kurse spitalet kanë marrë urdhër për të mos paraqitur raporte që do të pasqyronin gjendjen reale e faktike. Zjarret kanë prekur edhe Ukrainën fqinje, prandaj po bëhen përpjekje titanike për t'i mbajtur zjarret larg centralit kryesor bërthamor të Çernobilit që është 60 kilometra larg flakëve. Një e katërta e prodhimit bujqësor është shkatërruar.



Përmytjet në Pakistan

Nga ana tjetër, Pakistani po përballet me një katastrofë, që sipas Mauricio Xhiulianos, zëdhënës i Agjencisë për çështje Humanitare të OKB-së, është më e rëndë madje edhe se Cunami ose tërmeti që goditi së fundi Haitin. Numri i viktimave është afruar në 2000. Janë evakuuar rreth 500 mijë banorë nga Jakobabadi dhe 400 mijë nga Tuhli. Në zonën Kutsha ujërat kanë përmytur 25 mijë fshatra. Vërshimet kërcënojnë edhe bazën ushtarake të Shahbazit. Rreth 14 milionë vetë janë prekur deri tani nga katastrofa.



Përmytjet në Gjermani

Gjendja është dramatike, kurse ekziston rreziku që digat në provincën Sindh, nuk do t'u rezistojnë dot masave të tjera të ujit. 6 milionë banorë kanë nevojë urgjente për ushqim dhe ujë. Një vërshim i madh ka përfshirë edhe provincën Punjab pas reshjeve të forta të monsunit në veri të vendit.

Vërshimet kanë pllakosur edhe Evropën. Mbi 20 vetë kanë humbur jetën në Evropën Qendrore nga përmytjet e shkaktuara nga moti i keq e me



Përmytjet në Kinë

reshje të dendura shiu. Situata tejet e vështirë paraqitet në Poloni, ku janë evakuuar qindra banorë. Situata e rënduar paraqitet edhe në Gjermani, ku janë evakuuar afro 2000 banorë. Situata shumë e rënduar paraqitet edhe në Spanjë. Në Cuenca ujërat kanë mbuluar rrugët, garazhet, kantinat dhe lokalet tregtare. Në qytet ka rënë edhe stuhi rrebeshi. Kohë e keqe parashikohet edhe në Kanarie, Pireni, Katalonjë, Valencia, në Murcia dhe Baleari. Rënia e pemëve dhe shembja e disa godinave, të shkaktuara edhe nga era e fortë, kanë shkaktuar vdekjen e 4 personave në Lituani, ndërsa mijëra persona kanë mbetur pa



Duke shpëtuar nga përmytja - Poloni

energji elektrike.

Po ashtu, në Kinë llogaritet se afro 200 veta kanë vdekur si pasojë e rrëshqitjeve të dheut të shkaktuara nga shirat e dendura në veriperëndim të Kinës, ndërsa 2000 persona të tjerë llogariten si të zhdukur nga kjo katastrofë. Si pasojë e motit të keq, gjatë këtij viti në Kinë, kanë vdekur mbi 1100 njerëz, derisa qindra të tjerë llogariten të humbur.

Edhe në Korenë e Veriut shirat shkaktuan shkatërrimin e shtëpive, rrugëve, hekurudhave dhe të mbjellave. Autoritetet po zhvillojnë një numër takimesh të jashtëzakonshme. Mediet në shtetin komunist nuk kanë dhënë ende informacione nëse ka a jo viktime.



Shembja e tokës - Spanjë

Dielli po hedh flakë drejt tokës

Ky çrregullim i hatashëm klimaterik është pretekst për t'u ndezur sinjali alarmues në mbarë botën. Pasojat e ngrohjes globale veç po shihen. Provat për ngrohjen globale janë të pamohueshme, thuhet në një raport të ri të publikuar nga qeveria amerikane. Raporti i referohet punës së mbi 300 shkencëtarëve nga 48 vende të botës. Raporti thekson se janë gjetur temperatura më të larta mbi tokë, mbi oqeanë, temperatura më të larta në sipërfaqen pranë Tokës, nivele më të larta të deteve dhe më pak mbulesa akullnajore. Secila nga tri dekadat e fundit ka qenë më e nxehtë se paraardhësja, ndërsa periudha 2000-2009 është më e nxehta që kur shoqëria njerëzore ka nisur të masë temperaturën dhe të ruajë të dhënat. Nga ana tjetër, i ashtuquajtur "cunam

diellor", i cili shoqërohet me shpërthime të mëdha në formë fishekjarrësh në orbitën e Tokës, pritet të ndodhë gjatë këtyre ditëve të gushtit, duke shënuar dëme të jashtëzakonshme. Alarmi është dhënë nga shkencëtarët e NASA-s, të cilët kanë vërejtur se aktiviteti në sipërfaqen e Diellit është më i zjarrtë se zakonisht, ndërsa kjo do të shoqërohet jo vetëm me rritje të madhe të temperaturave, por edhe me hedhje të frikshme të flakëve drejt planetit tonë. Fishekjarrë të mëdha janë vërejtur nga satelitët këto ditë, kurse NASA paralajmëron për intensifikimin e tyre. "Këto shpërthime do të ndikojnë direkt në jetën e Tokës", - thuhet në raport. Madje këto flakë janë aq të ndritshme sa mund të dallohen edhe me sy të lirë në qiellin e hapur. Pasojat nga kjo mund të jenë ta paimagjinueshme. Së pari, Anglia dhe pastaj i gjithë globi do të mbetet pa energji elektrike. Nga stuhia magnetike komunikimet mund të pamundësohen dukshëm, sepse rrjetet kompjuterike dhe interneti nuk do të mund të funksiononin. Në bazë të lëvizjeve që po ndodhin, NASA parashikon që kjo krizë e gjithanshme të ndodhë në vitin 2013.

LEXIMET EKSPLOCITE

“Kam gjithë rrugës që po të mësoj të njohësh shenjat”.
(Umberto Eco “Emri i trëndafilit”)

Flamur MALOKU

Duhet të jemi të qartë që nga fillimi së këtu nuk është poenta që të kërkohet një relacion tekst-lexues, tashmë i stërthënë nga teoritë e shumta, por fjala është për fenomenin e ikjes së lexuesit prej eksplicitetit dhe futjes së tij në botën implicite të shenjave tekstore.

Teksti i flet lexuesit në gjuhën e shenjave, duke i thënë atij së një botë e tërë është brenda meje, por të mbetet ty lexues që ta zbulosh këtë botë, nëse i lexon shenjat. Nëse lexuesi nuk është i përgatitur për të hyrë brenda kësaj filozofie të tekstit, brenda kësaj kërkese, atëherë libri letrar në mënyrë arbitrare e përjashton lexuesin nga totaliteti, nga jeta e tij. Përjashtimi vjen nga mënyra që teksti letrar të mos keqkuptohet në esencë.


Dihet se veprën letrare çdoherë e kanë dëmtuar leximet eksplicite. Ekspliciteti, me dashje ose pa dashje, ka lënë anash kuptimet e shumta që prodhon teksti. Mbi këtë parim të mosnjohjes nga ana e shumë leximeve eksplicite, teksti është ngritur në vetëmbrojtje karshi tendencave dhe keqkuptimeve, duke i rezistuar këtij fenomeni. Kjo me së miri është vërejtur qartë edhe në kritikën socialiste, ku keqkuptimet së bashku me evidencat dhe parullat ishin të pashmangshme karshi tekstit letrar. Kur themi keqkuptime, kemi parasysh tendencat e kritikëve socialist, që tekstit letrar i veshnin lloj-lloj interpretimesh çoroditëse, duke shkuar çdoherë në dëm të tekstit. Për të mos u marrë gjatë me këtë kritikë, krejt kjo ka ardhur si rezultat i eksplicitetit ideologjik, duke mos hyrë kurrë brenda thurjes tekstore, ose në të shumtën e rasteve duke mos i njohur labirinthe, shenjat mbi të cilat është ndërtuar domeni i tekstit, sepse kështu edhe i konvenonte ideologjisë. Për këtë tip leximi, shenjat dhe kërkimi i tyre ishin eksplicite edhe atëherë nëse ato kërkoheshin, duke shkuar përherë në përjashtim total të implicititetit tekstor. Teksti letrar duhet t'i shërbejë politikës. Çfarë mund të thuhet me tepër?! Ishte kjo luftë e egër ndaj tekstit, kushtimisht mund të themi se ishte edhe vdekje për letërsinë, që shkonte në dëm të botës, aksio-poetikës. Mirëpo, varësisht kësaj, teksti i ka rezistuar kohës së ligë, ani pse tendencat për përjashtime e keqkuptime ishin formulë jete e kritikës socialiste. Kjo kritikë mund të themi se nuk e kishte edhe fuqinë e hyrjes në tekst. Kur mungon fuqia e hyrjes për perceptimin e shenjave, dihet se përjashtimet e keqkuptimet

ishin evidente, sepse hyrja në fenomenin e tekstit, kërkon pa diskutim edhe fuqi mendimi, njohje dhe lexim të shenjave dhe sa më shumë ikje prej ideologjisë dhe diskursit pragmatik.

Kapërcimi i pengesave

Teksti lexohet duke i lexuar shenjat. Shenjat janë thurur përtej një konteksti personal të autorit, përtej një përvoje të autorit dhe dikursit të mundshëm pragmatik e linear, siç thekson edhe teoricienti Ken M. Njuton se: “Diskursi letrar ekziston dhe ecën përtej çdo konteksti pragmatik, përtej çdo konteksti që mund të paraqesë ndonjë pengesë”. Ecja përtej çdo konteksti pragmatik dhe kohor, ka bërë që teksti t'i asimilojë edhe pengesat e shumta, duke i thyer skemat, evidencat dhe keqkuptimet pozitivistë. Kjo ishte lufta për mbijetesë.

Mirëpo, teksti vazhdoi jetën e tij. Duke qenë kjo, afrimet dhe venerimet shtoheshin në rrugë të mëtejme, për të mbetur çdoherë të lidhur



shpirtërisht me brendinë totale të leximeve implicite.

Brendia është filozofia e një thurje të aplikuar në pikëpamjen e domosdoshme të estetikës së dashuruar për jetën, duke qëndruar përherë larg eksplicitetit të mundshëm. Letërsia nuk e ka dashur kurrë 'eksplicitetin'. Ky koncept mund edhe të themi se është bërë i neveritshëm së funksionuari për lexuesit tashmë implicit. Jeta ka vazhduar bashkë me tekstin. Teksti i është bërë jetës hije e shenjë. Shenja jetë e jeta shenjë. Atëherë çfarë kërkon në këtë formulë lexuesi 'eksplicit'?

Pretendim për zhveshje

Shenjat përherë janë logjike. Kjo, në esencë, nënkupton edhe lidhjet e shumta, rrjetet, të cilat kur ndërthuren brenda një strukture totale funksionojnë së logjikuari falë kuptimeve. Ka pasur edhe përpjekje për mohim të kësaj teorie. Mirëpo, nga hulumtimi që i është bërë tekstit, ka rezultuar se shenjat, kur i nënshtrohen kompozicionit tekstor, funksionojnë së logjikuari përgjatë kuptimeve. Teksti nuk mund të ketë jetë pa një logjikim të shenjave. Duke qenë kjo e deklaruar tashmë nga teksti, leximi eksplicit vetëm sa do ta dëmtonte tekstin, siç e kemi theksuar edhe më lart. Nevojitet një durim i madh dhe dashuri e madhe për të hyrë brenda fundamentit të tekstit, nëpërmjet të cilit nuk vihet në dyshim hapja ndaj botës dhe domethënieve. Duke qenë teksti i hapur, pluraliteti tashmë i nënshtrohet veçantisë së investimit total nga ana e lexuesit, për të shënjuar vazhdimisht infinitin e pambaruar kuptimor. Domethënë mbi këtë, ndërlidhet e shumëzohet domosdoshmëria e kërkuar nga vetë fiksionaliteti logjik. Bota fiksonale bëhet thikë ndaj çdo tendence për zhveshje të tekstit. Pretendimi për zhveshje nuk është asgjë tjetër pos pretendim që teksti të bëhet 'parullë'. Mos të harrojmë se teksti letrar është tërësisht figurë. Aty ku është figura, nocioni 'reduktim' nuk ekziston. Derisa teksti vetvetiu e ka krijuar komoditetin e tij, lufta për vetëmbrojtje rritet në masë karshi pretendimeve për 'reduktimin' e kuptimeve dhe domethënieve nga leximet eksplicite.

Pluraliteti ekziston dhe derisa ai ekziston, atëherë ekziston edhe strategjia e notimit nëpër një grumbull shenjash logjike, që pa diskutim mund të interpretohen edhe nga aspekti gjuhësor, të cilat i kanë krijuar tekstit një pozitë të veçantë, për një komunikim sa më të hapur përballë lexuesit, sidomos për lexuesit model. Kjo është hapje ndaj lexuesit dhe ndaj botës. Kjo gjë nuk vërehet aspak nga lexuesi eksplicit. Shkallët në procesin e pluralitetit nga ekspliciteti janë reduktuar, ose hequr në masë të madhe. Shenja kurrë nuk është parë nga aspekti logjik. Teksti, duke qenë me kuptime infinite, ka arritur që të krijojë botën e tij. ■

Hatixhe BEQIRI

MOS PRIT

**O njeri
Zbritjet e mbledhjet
Rezultojnë me llogari të gabueshme
Nëse nuk e kupton para se të të mbyllet llogaria
E të fillojë procesi
Përpara Gjykatësit
Prandaj mendoje urën e Siratit
Edhe kur kalon shkujdesur rrugës aq gjerë
O njeri
Mos prit aroma e luleve të dhembjes
Të të dehë përgjithmonë.**

SEKRETI

**Balsamohem kur shoh diellin
Gëzohem që frymoj në dritë
Laneti paturpësisht më fton n'errësi
Për ta zbuluar sekretin do t'më gostitë
Me një gotë lëngu të zi,
nga më të mirët
Unë endem labirinteve pafund
E penduar bie dhe zgjohem
Risku shpejt mbaron
Dje meditova
Do të vdes sot
Nesër do të jetoj**

PËRVJETORI

**Në fustanin e bardhë
Qëndise trëndafilin e zi
Në përvjetor
Eja
Mbi derën e shtëpisë së vogël
Vare kurorën me lulëkuqe
Në lapidar
Fshima lotin kristal
Kujdes!
Mos i fshij vijat e portretit bardh e zi
Ndiqe vezullimën e dritës
Mblidhi kujtimet n'kohë
penën lage në gjakun tim të trashë
Shënoj dy vargje poetike
Për të mbetur në histori**

Intervistë me aktorin Mentor Zymberaj

NUK GUXOJMË TA HUMBIM DINJITETIN

Intervistoi: Blerta MALIQAJ

Mentor Zymberaj është njëri ndër aktorët më të mirë jo vetëm në Kosovë, por edhe në Evropë. Në festivalin “Aktori i Evropës”, aktori Zymberaj, ka marrë çmimin e parë, të cilin ia dedikon, siç thotë ai, “Shpirtrave të mëdhenj”.

PAQJA: Jeni shpallur aktori më i mirë në festivalin “Aktori i Evropës”. Çfarë do të thotë kjo për ju?

M. Zymberaj: Është ndjesi shumë e mirë kur shpërblehet puna e artistit, sidomos në festivalet ndërkombëtare, që në këtë rast ishte një festival shumë specifik me emër, po ashtu kur është një juri profesionale. Kënaqësia e artistit është shumë e madhe, sepse pak a shumë shpërblehet puna, si vlerë artistike. Është një kënaqësi për krijuesin e sotëm, sado që në kushte të vështira jeton ai, mirëpo ishte edhe një dëshmi që kjo shfaqje është një nga monodramat më të realizuara, jo vetëm në Kosovë, por edhe në rajon, për faktin

se gjatë edicionit 2009-10 mori pjesë në 10 festivale botërore dhe fitoi 8 çmime ndërkombëtare, diçka që rrallë ndodh. Ishte dëshmi e asaj se kjo shfaqje e ka merituar këtë vlerësim sidomos lojën e aktorit, që ata e kanë veçuar dhe e kanë vlerësuar shumë, që ishte vetë çmimi i festivalit “Aktori i Evropës”. Veç të tjerash ky ishte një fryt i kamotshëm i punës sime, ishte dëshmi jo vetëm për mua personalisht, por edhe për veprën pasi unë jam autor i saj, mirëpo edhe për skenën shqiptare dhe për Kosovën në veçanti, që në këtë kohë ka nevojë më shumë për t’i promovuar vlerat tona.

PAQJA: “Aktori në kuti” është një shfaqje që është paraqitur në skena të ndryshme. Sipas jush kujt i dedikohet më shumë sukcesi i saj?

M. Zymberaj: Këtë ua kushtoj “Shpirtrave të mëdhenj” të kësaj bote. Vetë tema thotë shumë për sakrificën e madhe që artisti bën për njerëzimin. Flas në mënyrë të veçantë për ndjenjën që ka për atë që ndodh në kohën dhe hapësirën që po jetojmë, sidomos në

Kosovë. Ua kam kushtuar pak a shumë njerëzve që kanë sakrifikuar shumë përmes punës së tyre, sidomos njerëzve të artit, gjë që vërehet gjatë lojës, sepse aty shpesh citohen thënie të aktorëve të mëdhenj dhe luhen role të artistëve të mëdhenj.

Personazhi në këtë monodramë quhet Dini, fjala është për aktorin e madh Samedin Latifin, i cili ka përjetuar një vdekje jo të rëndomtë faktikisht, por një vetëvrasje të ngadaltë. Pikërisht për faktin se njerëzit nuk e kanë vlerësuar punën e tij dhe nuk i janë përkushtuar artit dhe atij në veçanti, i cili ka pasur vlera të mrekullueshme si krijues i kohës. Atë e kam njohur edhe personalisht dhe një pjesë i është kushtuar atij. Një citat po ashtu i kushtohet të zhdukurve, të cilët janë dhembja jonë më e madhe dhe artistët nuk mund ta anashkalojnë kurrsesi këtë temë. Ky është projekti i gjashtë që kam realizuar për të zhdukurit. I kushtohet fëmijërisë së hershme, asaj që njerëzit tek ne kanë një civilizim shumë të lashtë edhe aktori në kutinë e vet kërkon që të jetë i pranishëm nëpër qytetet antike. Pra, braktis teatrin kombëtar, që të vijë në pah vlera e popullit të tij për të cilin ai jep shumë, mirëpo në vendet për të cilat ky mendon se ka qenë civilizim i hershëm ka rrënjë të thella ky civilizim. Është gjetur mundësia për t’i thënë në monodramën dhe shtjellimin e saj, pasi që duke kërkuar qytetet antike shqiptare ose ilire has në një vend të minuar, ku pastaj nuk mund të kthehet. Prandaj e gjithë ajo se çka thotë është një klithje rreth asaj se çfarë i ka ndodhur aktorit, i cili pret vdekjen e tij të ngadalshme gjë që brenda kohës sa e pret vdekjen ka çka thotë.

PAQJA: Si e vlerësoni artin skenik shqiptar në përgjithësi

M. Zymberaj: Kemi shumë tema origjinale tonat, të cilave ua kemi borxh një civilizimi dhe ne nuk mund t’i ikim gjeneve tona. Ishte një organizim “Arti kundër dhunës”, në Oslo, në vitin 2000, në Muzeun e Vikingëve. Aty ishte një prej anijeve në të cilën është gjetur një gjerdan femre dhe kjo ka rëndësi shumë të madhe për ne dhe historinë tonë, tregonte ciceroni. Unë





i thashë se çfarë do të flasim ne kur në atë kohë kemi pasur mbretëreshën Teutë, e cila e ka udhëhequr flotën më të shpejtë. Ne i takojmë një civilizimi shumë të hershëm, për të cilin duhet të luftojmë. Pasi edhe historia jonë është nëpërkëmbur ngase ne kemi një histori shumë të bujshme në të vërtetë, por njerëzit tanë kanë punuar për historinë e të tjerëve. Mendoj se kemi hapësirë që, arti në përgjithësi dhe ai skenik, të kthehen aty ku e kanë vendin në rrënjët e veta, ne kemi një shkollë të mrekullueshme të artit skenik, e cila është në kuadër të Fakultetit të Arteve. Aty bëhet një punë e madhe si me dramaturgë, ashtu me regjisorë dhe me aktorë. Mundësinë e kemi, por duhet një përkrahje institucionale, përveç sakrificës së artistëve, e cila nuk mungon asnjëherë.

PAQJA: Çfarë mendoni në lidhje me statusin e aktorit në Kosovë?

M. Zymeraj: Për nga ana financiare, trajtimi që iu bëhet artistëve është në një gjendje të mjerueshme. Shpesh duhet të ballafaqohemi me gjërat më elementare të jetës, derisa në vendet e ndryshme të botës artistët janë të privilegjuar. Ata janë ambasadorë të artit dhe kulturës në botë dhe zhvillojnë shpirtin e popullit të vet. Te ne është lënë si punë e dorës së dytë. Do të kishte rëndësi të madhe hapësira që do t'u jepej artistëve për nga ana materiale,

sepse publiku dhe populli në përgjithësi e dinë vlerën e artistit, e dinë çdo të thotë krijues dhe kuptimin e epitetit artist. Për të qenë artist në këtë kohë është një sakrificë shumë e madhe, sepse duhet të orientohesh, veç fuqisë profesionale edhe në atë shpirtërore. Të harrosh një pjesë të madhe të jetës dhe privilegjeve të saj dhe të orientohesh kryesisht në zhvillimin e artit. Vuajtja e artistëve është shumë më e madhe, dhe shpesh ndodhë që artisti të punojë diçka tjerët nga profesioni i vet, që të merret me diçka sa për të jetuar. Nuk guxojmë ta humbim dinjitetin e artistit dhe ne duhet të luftojmë shumë që artisti të jetë shumë i dinjitetshëm, sepse prezantimi në vende të ndryshme është si punë institucionale. Kjo sepse përfaqëson Kosovën si ambasador i vendit tënd. Artistëve ju duhet hapësirë dhe nxitje, për shkak të nevojës së zhvillimit të artit dhe kulturës.

PAQJA: Cilat janë projektet tuaja?

M. Zymeraj: Këtë vit po festoj jubileun e 15-të të Shtëpisë Teatrorë Filmike "ART", me të cilën i kemi realizuar disa vepra, tri prej tyre filma, dy artistikë dhe një i shkurtër, një radiodramë dhe 29 drama, të gjitha tema tonat origjinale. Kjo shtëpi artistike është tipike shqiptare. Ky vit ka qenë vit i sukseseve të mëdha, i festivaleve, siç ishte monodrama "Aktori në kuti" që u shpërblye tetë herë me çmime ndërkombëtare.

Pastaj filmin të cilin e kemi realizuar "Refren për Kosovën", në bashkëpunim me "Durahym Produksion" nga Amerika, i cili ka qenë pjesëmarrës në kuadrin e filmave të shkurtër të festivalit në Kanë, që është sukses shumë i madh. Kemi realizuar festivalin e dytë të festivalit të monodramës "Mono Art" në Kosovë dhe tani jemi anëtarë të barabartë të Asociacionit Ndërkombëtar të Monodramave. Kemi plane dhe ftesa të shumta, siç është ai për Skenën Verore në Ulqin, Festivali Ndërkombëtar i Teatrove, në Vlorë dhe në Festivalin e Mono Performancave në Sllovakia më 15 shtator. Me sukseset e sivjetme e kemi arsyetuar punën e shumë viteve dhe në fund të këtij viti do ta organizojmë javën e madhe të kësaj shtëpie, me këtë rast do të falënderojmë të gjithë ata që kanë dhënë kontribut në zhvillimin e artit filmik dhe do të ndajmë mirënjohje. Kemi edhe plane të tjera, jemi pranë shfaqjes së premierës "1999", me tekst dhe regji timen dhe interpretim të studentëve të Fakultetit të Arteve të Prishtinës. Jam në realizim të një teme tjetër të monodramës, e cila do të jetë në edicionin e ardhshëm dhe mjaft plane të tjera. Në fund kërkoj që arti të ketë vendin e vet aty ku duhet, sepse vlerat tona e meritojnë të çmohen, ngaqë cak i të gjitha kulturave në botë është zhvillimi i vlerave të veta dhe ruajtja e tyre. Dhe ne jemi segment shumë i rëndësishëm i kësaj qasjeje. ■

Pas GJND-s përballje edhe në sport

Kosova dhe Serbia do ta kenë edhe një betejë të radhës, por tani në sport. Pas vendimit të GJND-s, që legjitimoi pavarësinë e Kosovës, pritet të ndodhë edhe një përballje tjetër. Klubi i hendbollit Kastrioti do të ndeshet me klubin serb Knjaz Milosh

Alban BILALI

Pas përballjes së Kosovës me Serbinë në Gjykatën Ndërkombëtare të Hagës për legjitimitetin e Pavarësisë së Kosovës, pritet të ndodhë edhe një përballje tjetër, por tani në sport, në hendboll. Shorti i hedhur nga Federata Evropiane e Hendbollit (EHF) ka vënë si rival në konkurrencën e femrave Kastriotin e Ferizajit me skuadrën serbe Knjaz Milosh. Ndeshja, e organizuar nga Federata Evropiane e Hendbollit (EHF), pritet të luhet në një terren neutral, për t'iu shmangur incidenteve që mund të jenë të mundshme. Takimet vajtje-ardhje pritet të zhvillohen në datat 13 nëntor dhe 20 nëntor, ku vashat e Kastriotit do të jenë nikoqire. Balafaqimi Knjaz Milosh – Kastrioti i takon rrethit të tretë të Kupës së fituesve të kupave.

Mirëpo, si përfaqësuesit e Kastriotit, ashtu edhe ata të Knjaz Miloshit, thonë se nuk do ta kishin problem t'i zhvillonin ndeshjet në Kosovë dhe Serbi, pasi që ata insistojnë që politika të mos përzihet në sport.

Trajneri i Kastriotit, Ismet Jupa, nuk sheh asgjë të keqe që ekipi i tij ta luajë njëren lojë në Ferizaj, e tjetrën në Serbi. Por, ai thotë se ferizajasit do ta pranoinin çdo vendim të EHF-së, qoftë edhe ai për të luajtur në terren neutral.

"FHK-ja është e pranuar në EHF-ja, edhe pse me të drejta të kufizuara. Andaj, nuk kemi arsye për të mos luajtur. Është politikë e Federatës besoj, por edhe e klubit tonë që t'i zhvillojmë ndeshjet, qoftë në Serbi, qoftë në terren neutral, kudo. E, sa i përket ekipit kundërshtar, është punë e tij a pranon të luajë a jo", - tha Jupa.

Sa i përket skuadrës serbe në aspektin sportiv, Jupa ka thënë se Knjaz Milosh është skuadër e fortë dhe me traditë dhjetëvjeçare në garat ndërkombëtare dhe se me disa përforcime do të mundohen të nxjerrin rezultat të favorshëm. *"Kam informacione për skuadrën serbe. Bëhet fjalë për një skuadër serioze dhe shumë të fortë. Janë pjesëmarrës të rregullt në 10 vjetët e fundit nëpër kupat evropiane. Realisht nuk kemi potencial të luajmë kundër tyre, por me disa përforcime do të mundohemi të bëjmë të pamundurën dhe do të përpiqemi të nxjerrim rezultat të favorshëm",* - është shprehur Jupa.

Në anën tjetër, edhe sekretari gjeneral i klubit Knjaz Milosh, Bojan Nikitoviç, ka thënë se janë të gatshëm t'i masin forcat me hendbollistët ferizajase.

"Që 12 vjet marrim pjesë në gara ndërkombëtare dhe pavarësisht se vjen në një moment të ndërlikuar politik, Knjaz Milos do të vazhdojë të luajë, pa marrë parasysh kundërshtarin", - ka thënë për gazetën serbe Novosti, Bojan Nikitoviç.

"Jemi të gatshëm të luajmë, si në Arandjelovac, si në Ferizaj. Do t'i respektojmë të gjitha vendimet e EHF-së dhe Federatës sonë në kuadër të së cilës veprojmë. Ne jemi sportistë dhe merremi me sport, e politikanët le të merren me politikë. Do të mundohemi të jemi mikpritësit më të mirë", - shtoi ai.

Kjo nuk është hera e parë që një klub nga Kosova dhe Serbia përballen mes vete. Në sezonin 2006/2007, Vëllaznimi në konkurrencën e femrave u përball edhe me klubin Nisa, ku fituan hendbollistët nga Nishi, në ndeshjen që u zhvillua në një terren neutral, në Hungari. ■



Intervistë me futbollistin kosovar, Andis Shala, të skuadrës scoceze Dundee United

Shala është i gatshëm të luajë edhe si qendërmbrojtës në Shqipëri

“Shpresoj të ftohem për ndeshjen kualifikuese, pasi jam i gatshëm dhe me padurim pres të jap kontributin tim. Edhe pse jam i ri, jam tepër i bindur se do të ftohem për ndeshjet eliminatorë. Dua të luaj për Shqipërinë dhe mbi të gjitha jam krenar që Kuzhe flet dhe interesohet për mua. Të shënosh gola është gjë shumë e mirë. Por kënaqësia më e madhe është kur i ndalon kundërshtarët të shënojnë gola dhe këtë e kam zbuluar vetëm tash”, - ka thënë Shala.

Intervistoi: Dilaver POLISI

Futbollisti kosovar, Andis Shala është shprehur i gatshëm që të luajë si qendërmbrojtës për Kombëtaren e Shqipërisë në eliminatorët për Kampionatin Evropian të vitit 2012, që do të mbahet në Ukrainë dhe në Poloni. Shala 21-vjeçar është në pritje të ftesës nga trajneri i Kombëtares së Shqipërisë, Josip Kuzhe, i cili më herët pati thënë publikisht se llogarit në Shalën dhe se po e përcjell vazhdimisht përmes të angazhuarve të tij. Sulmuesi i ekipit scocez Dundee United, thotë se po ndihet mjaft mirë në pozitën e re. Ai tash është më i lumtur që të ndalojë shënimin e golave sesa t'i shënojë ato. Trajneri i Dundee Unitedit, Peter Houston, i propozoi Shalës që të luante në mbrojtje dhe kosovari pranoi duke thënë se lojtari i mirë mund të luajë në çdo pozitë.

“Shpresoj të ftohem për ndeshjen kualifikuese, pasi jam i gatshëm dhe pres me padurim të jap kontributin tim. Edhe pse jam i ri, jam tepër i bindur se do të ftohem për ndeshjet eliminatorë. Dua të luaj për Shqipërinë dhe mbi të gjitha jam krenar që Kuzhe flet dhe interesohet për mua. Të shënosh gola është gjë shumë e mirë. Por kënaqësia më e madhe është kur i ndalon kundërshtarët të shënojnë gola dhe këtë e kam zbuluar vetëm tash”, - ka thënë Shala.

“Garry Kenneth, Darren Dods, unë dhe Sean Dillon jemi duke luftuar për pozitën e qendërmbrojtësve. Por edhe nëse trajneri transferon ndonjë mbrojtës të ri, atëherë do të jetë mirë për garë. Por nëse nuk ndodh kështu, atëherë unë pas disa ndeshjeve do të jem i gatshëm të luaj në Premier League të Skocisë. Vërtet më pëlqen të luaj në pozitën e qendërmbrojtësit, ta shoh lojën përpara. Është një mënyrë tjetër për të shikuar lojën, veçanërisht kur mësohesh të luash si sulmues. Lëvizjet janë ndryshe. Por unë

i di të gjitha lëvizjet që bëjnë sulmuesit, kështu që do të jetë mirë për mua. Mund të jem një hap para tyre”.

Në fakt, para disa javëve, propozimin për pozitën e re në qendër të mbrojtjes ia kishte propozuar trajneri i tij.

Shala 21-vjeçar që gjatë karrierës ka luajtur si qendërsulmues është aktivizuar në ndeshjen përgatitore kundër skuadrës rumune Unirea Urziceni në qendërmbrojtje. Trajneri Houston e ka pëlqyer atë që ka parë dhe mendon ta aktivizojë edhe më tutje Shalën në mbrojtje. Shala i gjatë 191 centimetra është aktivizuar në të njëjtën pozitë edhe në ndeshjen kundër Arka Gdynia.

“Nëse Shala kthehet në qendërmbrojtës, atëherë do të shkojë hapave të legjendës së Dundee Unitedit, Paul Hegarty. Edhe ky i fundit ishte kthyer nga sulmues në mbrojtës, ndërsa në Dundee United luajti nga viti 1974 deri në vitin 1990, duke qenë kapiten i kësaj skuadre për shumë vite. Tash është në stafin e trajnerëve të Dundee”, - ka thënë trajneri i Dundee United, Peter Houston. “Mendoj se Andisi ka një të ardhme të mirë si qendërmbrojtës. Disa njerëz përbalën më lehtë me lojën kur e

kanë para vetes sesa prapa. Shala në një të ardhme mund të jetë një nga ata lojtarë. Ai nuk është i bekuar me shpejtësi të madhe, por është impresiv në luftën në ajër”, - ka thënë trajneri Houston, shkroi ‘Scotsman’.

Shala në verën e vitit 2008 u transferua te Dundee United nga skuadra gjermane e rangut të ulët Mannheim. Ai, në këtë edicion në Premier Leaguën e Skocisë, është paraqitur në shtatë ndeshje deri më tani. Shala thotë se kohët e fundit ka vuajtur nga një lëndim dhe kjo është arsyeja kryesore që nuk është inkuadruar më shpesh te Dundee. Pasi ka sanuar lëndimin, ai pret të ketë rastin e vet dhe të tregohet.

“Tash për tash nuk jam duke luajtur shumë te Dundee, por e di shumë mirë se koha ime këtu do të vijë dhe në secilën ndeshje do të jem titullar dhe do të shënoj”, - tha Shala. “Kohët e fundit kam oferta nga disa skuadra angleze, por unë dua të mbetem te Dundee dhe t'i tregoj vlerat e mia”.

Shala ka kontratë valide me ekipin scocez deri në qershorin e vitit të ardhshëm. Ai është i biri i ish-futbollistit të mirënjohur Kujtim Shala. ■

